

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5560
E hënë, 27 gusht 2018
çmimi 0.40 €

Kuvendi në shtator i rikthehet punës



Nga muaji shtator Kuvendi i Kosovës, pas pushimeve dhe pas një sesiioni paraprak të vlerësuar si jo shumë produktiv për shkak të problemeve me vendimmarrje, pritet ta rifillojë punën | FQA 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

IDEJA PËR 'KORRIGJIMIN E KUFIJVE', ZHBËRJE E PROCESIT TË PAVARËSIMIT TË KOSOVËS! F. 6



Bilall SHERIFI

TRENI PËR BRUKSEL F. 11



Shkruan: MSC.
Ramadan BARALIU

BACA ADEM DEMAÇI VDIQ I QETË F. 11



Selatin
NOVOSELLA

GJERGJ KALAJ, SHOIPERINË E DESHI ME ZEMËR E ME SHPIRT F. 11



Ismet SYLEJMANI

EKONOMI

RRITET EKSPORTI NGA KOSOVA PËR NË GJERMANI F. 8

SPORT

FLAMURTARI E 'FIK' KAMPIONEN, PRISHTINA FITON DERBIN NDAJ '89-shit F. 20



FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ

Paralajmërimet për mocion ndaj Qeverisë, joserioze

Ministri i Infrastrukturës nga partia Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, nuk u frikësohet paralajmërimeve të opozitës për mocion mosbesimi ndaj Qeverisë Haradinaj. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Lekaj ka thënë se këto pretendime të

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) janë joserioze, duke shtuar se këtë refren ky subjekt politik e ka përsëritur prej ditës që Ramush Haradinaj është bërë kryeministër i vendit. Lekaj ka bërë me dije se nëse opozita do ta kishte shumicën në Kuvend, atëherë Qeveria do të

dorëhiqej. Duke folur rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi, ai ka theksuar se Qeveria Haradinaj nuk pranon kompromise të reja në këtë proces. "Prandaj çdo kompromis që e kalon pakon e Ahtisarit, Qeveria Haradinaj e konsideron të dëmshëm", është shprehur Lekaj


Thaçi dhe Vuçiqi kërkojnë ndihmën e ndërkombëtarëve për arritjen e marrëveshjes përfundimtare

FQA 3



Marrëveshja përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk mund të arrihet pa mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare. Kështu kanë thënë të dielën presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ai i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në

kuadër të punimeve të Forumit Evropian Alpach në Austri. Duke folur për arritjen e kësaj marrëveshje, presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova dhe Serbia nuk do të jenë as të parat e as të fundit që do të bëjnë korrigjim të kufirit për hir të paqes



Kosova e pikëlluar për vdekjen e senatorit McCain

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878


SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ka ndërruar jetë senatori amerikan John McCain

Kosova e pikëlluar për vdekjen e senatorit McCain

Senatori amerikan John McCain ka vdekur në moshën 81-vjeçare. Ai ka qenë gjashtë herë senator republikan nga Arizona dhe hero i luftës që ka duruar gati gjashtë vjet torturë dhe robëri në burgun famëkeq Hanoi Hilton. Ai ka treguar mjaft interesim për çështjet e Ballkanit dhe e ka vizituar disa herë rajonin. Liderët e Kosovës kanë shprehur ngushëllime me rastin e vdekjes së mikut të madh të shqiptarëve, senatorit amerikan John McCain



WASHINGTON, 26 GUSHT - Senatori amerikan John McCain, gjashtë herë senator republikan nga Arizona dhe hero i luftës që ka duruar gati gjashtë vjet torturë dhe robëri në burgun famëkeq Hanoi Hilton, ka vdekur në moshën 81-vjeçare. I njohur për qëndrimin luftarak gjatë gjithë dekadave në Senat dhe për dy përpjekje të dështuara për t'u zgjedhur president i Shteteve të Bashkuara, McCain ka vuajtur nga kanceri në tru. Ai ka qenë i rrethuar nga familja dhe miqtë në Arizona në ditët e fundit, ndërsa ka ndërruar jetë pas publikimit të librit të tij të fundit "Vala e shqetësimit: Kohët e mira, kauzat e drejta, luftërat e mëdha dhe vlerësimet e tjera". Në librin e tij, McCain ka pranuar se nuk ka ide se sa kohë i ka mbetur për të jetuar, porse kjo nuk e ka ndaluar ta godasë presidentin aktual Donald Trump, të shprehë keqardhje për zgjedhjen e ish-governatores së Alaskës, Sarah Palin, si kandidatë për zëvendëse të tij në fushatën e vitit 2008, si dhe të shprehë shqetësime për reputacionin ndërkombëtar të vendit të tij.

McCain ka lindur në Stacionin Detar Solo Coco të Panamasë më 29 gusht 1936, në një familje me histori të thellë ushtarake. Duke ndjekur gjurmët e babait dhe të gjyshit të tij, të dy admiralë me katër yje, ai ka diplomuar në Akademinë Detare në Anapolis në vitin 1958. Më pak se një dekadë më vonë ai është dërguar në Vietnam, ku aeroplani i tij është goditur në Hanoi. Pavarësisht dy duarve të thyera, gjurit të thyer dhe torturës së vazhdueshme, McCain i ka refuzuar ofertat për lirim të parakohshëm nga robëria, duke thënë se ai do të largohet vetëm kur i burgosuri i fundit amerikan të dalë nga dera. "Kam rënë në dashuri me vendin tim kur kam qenë i burgosur në vendin e dikujt tjetër", ka thënë McCain kur ka pranuar emërimin e Partisë Republikane për kandidat në zgjedhjet presidenciale të vitit 2008. "I kam dashur Shtetet

e Bashkuara për dinjitetin e tyre, për besimin në urtësinë, drejtësinë dhe mirësinë e popullit të tyre. I kam dashur sepse nuk kanë qenë vetëm një vend, por një ide, një kauzë për të cilën duhet luftuar. Nuk kam qenë kurrë i njëjti përsëri. Nuk kam qenë i vetes sime më, kam qenë i vendit tim", ka thënë McCain. Por, ai ka vazhduar të jetë vetja. Si senator, ai i ka sfiduar presidentët, pavarësisht përkatësisë partiake, nëse e ka ndërjet se politikat e tyre nuk janë në përputhje me pikëpamjet e tij. Në sytë e publikut, ai është transformuar nga hero i luftës në ikonë politike, duke fituar reputacionin e një rebeli. McCain tregoi mjaft interesim për çështjet e Ballkanit dhe e ka vizituar disa herë rajonin. Në prill 2017, gjatë një vizite në Kosovë, ai kujtoi përpjekjet e bëra në rrugën e Kosovës për të arritur tek pavarësia. "Me gjithë përparimin që ka bërë Kosova,

ende mbeten shumë punë për t'u bërë. Por në këtë punë, ju nuk do të jeni vetëm. ShBA-ja është e gatshme t'ju mbështesë për t'i përbushur sfidat dhe për t'i shfrytëzuar mundësitë që keni përpara. Nëse më lejoni, si një mik i vjetër që dëshiron ta shohë Kosovën të ketë sukses, do të doja të ndaja me ju shpresat e mia për të ardhmen e ndritur të Kosovës", pati thënë McCain në Kuvendin e Kosovës. Gjatë mandatit të tij të parë në Kongres ai është ngritur kundër presidentit Ronald Reagan, një republikan i respektuar deri më sot, për shkak të vendimit të tij për t'i vendosur marinsat paqeruajtës në Bejrut me

kapacitete të kufizuara mbrojtëse. Nami i tij është rritur derisa vazhdimisht ka sfiduar presidentin tjetër republikan, George W. Bush, në lidhje me shkurtimet e taksave, akuzat për tortura dhe strategjinë e ShBA-së në Irak.

Liderët botërorë nderojnë senatorin McCain

Liderë nga e mbarë bota kanë nderuar senatorin amerikan John McCain. Flamujt u ulën në gjysmështizë në Shtëpinë e Bardhë, teksa presidenti amerikan, Donald Trump, që shpesh është përplasur me të, madje edhe është tallur me McCain - ka çmuar figurën e sen-

atorit nga Arizona. "Keqardhja ime e thellë dhe respekti shkon për familjen e senatorit John McCain. Zemrat tona dhe lutjet tona janë me ju", ka shkruar në "Twitter" presidenti Trump. Paraardhësi i Trumpit, Barack Obama, i cili e kishte mundur McCainin në zgjedhjet presidenciale të vitit 2008, ka thënë se "jemi të gjithë në borxh ndaj tij". "John McCain dhe unë ishim pjesëtarë të gjeneratave të ndryshme, me prejardhje të ndryshme, por konkurruam në nivelin më të lartë të politikës. Por kemi ndarë, me gjithë dallimet tona, një besnikëri të diçkaje më të madhe - të idealeve për të cilat brezat e amerikanëve dhe emigrantët kanë luftuar, marshuar dhe sakrifikuar", ka thënë Obama. Kryeministria britanike Theresa May ka thënë se McCain ka "personifikuar idenë e shërbimit mbi vetveten", ndërkaq presidenti francez Emmanuel Macron e ka quajtur senatorin "hero të vërtetë amerikan, zëri i të cilit do të mungojë". Ministri i Jashtëm gjerman Heiko Maas ka thënë se McCain ka qëndruar për një Amerikë "që është e besueshme dhe e afërt me partnerët që ndërmerr përgjegjësi të mëdha për të tjerët dhe qëndron prapa vlerave dhe principeve edhe në kohë të vështira".

Kosova kujton mikun McCain

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka shprehur ngushëllimet e tij në emër të popullit të Kosovës me rastin e vdekjes së mikut të madh të shqiptarëve, senatorit amerikan John McCain. Në një postim në llogarinë e vet në "Twitter", presidenti Thaçi e ka cilësuar hero senatorin amerikan, ndërsa ka shfaqur ndjenjë pikëllimi për humbjen e tij. "I gjithë populli i Kosovës dhe unë u jemi bashkuar dhimbjes së familjes e miqve me rastin e ndarjes nga jeta të senatorit amerikan John McCain. Një nga udhëtimet e tij jashtë vendit ishte ai i vitit 2017 në Kosovë, kur unë i dhashë atij urdhrin më të lartë të meritës. Ai ishte një ndër heronjtë e fundit të vërtetë të kohës sonë", ka shkruar Thaçi. Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është shprehur i pikëlluar pas vdekjes së senatorit amerikan John

McCain. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", Veseli ka thënë se Kosova ka qenë e bekuar që ka pasur miq të tillë si McCain. Për vdekjen e senatorit McCain ka reaguar edhe kryeministri Ramush Haradinaj. "I pikëlluar nga lajmi për vdekjen e senatorit republikan të ShBA-së, John McCain, familjes së tij, Senatit të ShBA-së dhe qytetarëve amerikanë, u shpreh ngushëllimet më të sinqerta të popullit dhe të Qeverisë së Kosovës", ka shkruar kryeministri Ramush Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se me dhimbje ka marrë lajmin për vdekjen e mikut të madh të shqiptarëve, senatorit republikan John McCain. "Qytetarët e Kosovës nuk do ta harrojnë asnjëherë kontributin e senatorit



McCain i cili i dha mbështetje Kosovës në çastet më të rëndësishme për vendin tonë", ka thënë Limaj. Edhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka

reaguar për vdekjen e senatorit amerikan John McCain. Pacolli ka thënë se senatori McCain, përveçse hero i ShBA-së, ishte dhe do të mbetet edhe hero për Kosovën.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë në Forumin Evropian Alpbach, në të cilin është diskutuar për zgjerimin e BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor

Thaçi dhe Vuçiqi kërkojnë ndihmën e ndërkombëtarëve për arritjen e marrëveshjes përfundimtare

Marrëveshja përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk mund të arrihet pa mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare. Kështu kanë thënë të dielën presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ai i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në kuadër të punimeve të Forumit Evropian Alpbach në Austri. Duke folur për arritjen e kësaj marrëveshje, presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova dhe Serbia nuk do të jenë as të parat e as të fundit që do të bëjnë korrigjim të kufirit për hir të paqes

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 26 GUSHT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ai i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të dielën kanë marrë pjesë në punimet e Forumit Evropian Alpbach në Austri, ku kanë kërkuar mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare për arritjen e marrëveshjes përfundimtare në kuadër të dialogut ndërmjet dy vendeve e cila mund të parashohë edhe korrigjim të kufijve. Me këtë rast, presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Kosova dhe Serbia janë të përfshira në një proces shumë të vështirë të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, duke qenë të vetëdijshme se me çdo çmim duhet të ruhen stabiliteti dhe paqja në Ballkanin Perëndimor. "Ne tani kemi hyrë në fazën përfundimtare të këtij procesi dhe kemi nevojë për mbështetje të plotë nga BE-ja, shtetet anëtare të saj, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga pjesa tjetër e bashkësisë ndërkombëtare që të arrihet një marrëveshje potenciale ligjërish detyruese midis Kosovës dhe Serbisë. Ne jemi krejtësisht të vetëdijshëm për nevojën që stabiliteti dhe paqja në Ballkanin Perëndimor të ruhen me çdo çmim. Kjo është arsyeja pse ne duam t'i sigurojmë shtetet fqinje, shtetet anëtare të BE-së apo shtete të tjera të botës, se nuk duhet të kenë frikë nga një marrëveshje potenciale paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, edhe nëse një marrëveshje e tillë nënkupton korrigjim të kufirit", ka deklaruar Thaçi në një konferencë të përbashkët me gazetarë. Sipas tij, Kosova dhe Serbia nuk do të jenë as të parat e as të fundit që do të bëjnë korrigjim të kufirit për hir të paqes duke i dhënë fund një konflikti prej një shekulli.

Thaçi ka thënë se pa këtë marrëveshje vendet do ta bllokojnë njëra-tjetrën në avancimin e mëtejshëm drejt anëtarësimit në BE dhe rajoni do të vazhdojë të vuajë nga rreziku i jostabilitetit. "Dëmet nga mosarritja e marrëveshjes do të jenë të larta, por përfitimet në rast të arritjes së saj janë shumë më të larta jo vetëm për Kosovën dhe Serbinë, për rajonin dhe BE-në, por edhe më gjerë. Prandaj, kemi vendosur të shqyrtojmë çdo mundësi për të gjetur zgjidhje kreative dhe për të arritur një marrëveshje të pranuar reciprokisht. Nëse kështu do të ndodhë, Kosova dhe Serbia nuk do të jenë as të parat e as të fundit që do të bëjnë korrigjim të kufirit për hir të paqes dhe t'i japin fund një konflikti prej një shekulli", është shprehur Thaçi. Presidenti Thaçi ka folur edhe për procesin e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, duke thënë se ky rrugëtim për të gjithë, në veçanti për Kosovën, ka qenë dhe mbetet i gjatë dhe i vështirë. "Sigurisht për ne që përfaqësojmë shtetet e Ballkanit Perëndimor këtu në këtë forum, perspektivat për zgjerimin e BE-së ishin dhe mbeten prioritet. Së këndejmi, ne të gjithë shprehëm angazhimin dhe vullnetin tonë për të punuar fort për t'i jetësuar qëllimet tona, pra që gjashtëshen e mbetur të Ballkanit Perëndimor të sjellim më pranë anëtarësimit në BE. Ky rrugëtim për të gjithë ne, në veçanti për Kosovën, ka qenë dhe mbetet rrugëtim i gjatë dhe i vështirë. Prandaj, unë dhe qytetarët e Kosovës jemi të vendosur për të arritur këtë qëllim. Ne do të bëjmë pjesën tonë të punës por, gjithashtu, presim që edhe BE-ja e shtetet e saj anëtare ta bëjnë pjesën e tyre", ka theksuar Thaçi. Edhe presidenti i Serbisë,



Aleksandër Vuçiq, ka thënë se problemet duhet të zgjidhen për hir të dy popujve dhe të gjithë rajonit në përgjithësi. "Shpresoj të arrijmë një marrëveshje të qëndrueshme, ndonëse ende jam shumë pesimist sepse i shoh vështirësitë me të cilat përballemi dhe nuk jam i sigurt nëse njerëzit në Beograd e në Serbi do të mbështesin çfarëdo marrëveshje, por do të bëjmë më të mirën për zgjidhjen e kësaj çështje", ka deklaruar Vuçiqi, duke shtuar se kjo nuk mund të arrihet pa mbështetjen e të gjithë

Bashkimit Evropian meqë, sipas tij, marrëveshja duhet të jetë e dhimbshme për të dyja palët. "E përbashkëta jonë është se duam ta gjejmë rrugën për një marrëveshje që ka të bëjë me njerëzit tanë dhe të ardhmen e tyre. Kemi folur shumë për rrugën tonë evropiane dhe kjo do të ishte qershia mbi tortë, por paqja e qëndrueshme ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve është arritje e madhe dhe për këtë po punojmë. Por nuk mund të flasë për hollësi rreth marrëveshjes së mundshme", ka theksuar Vuçiqi.

Kurse presidenti i Austrisë, Alexander Van der Bellen, ka thënë se të dy presidentët janë të përkushtuar për të gjetur një zgjidhje që do t'i ndihmojë qëndrueshmërisë së rajonit. Sipas tij, takimi i presidentëve Thaçi - Vuçiq në Alpbach i ka krijuar ndjenjën e një çasti historik. Po ashtu, edhe komisionari për zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, ka thënë se çfarëdo zgjidhje që të arrihet, duhet të respektohet synimi i përbashkët që është qëndrueshmëria në rajon dhe që nuk do të nxisë ide shtesë.

Kurtz: Arritja e marrëveshjes Kosovë - Serbi, parakushti kryesor për anëtarësim në BE

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të dielën ka mbajtur një takim të përbashkët me kancelarin austriak Sebastian Kurtz, komisionarin e BE-së për Zgjerim, Johannes Hahn, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Kancelari austriak, si nikoqir i këtij takimi, ka bërë me dije se Austria gjatë udhëheqjes së Presidencës së BE-së prioritet kryesor do t'i ketë politikën e zgjerimit dhe të fqinjësisë së mirë, si dhe ato të sigurisë dhe migracionit. Fokus primar i këtij takimi ka qenë edhe procesi i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë i ndërmjetësuar nga BE-ja. Kurtz i ka inkurajuar të dy presidentët për t'i vazhduar përpjekjet e tyre për ta arritur marrëveshjen. "Arritja e marrëveshjes është parakushti



kryesor për anëtarësimin e dy shteteve në BE. Austria mbështet dialogun dhe arritjen e marrëveshjes si dhe integrimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor në BE", ka theksuar Kurtz. Ndërkaq presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka falënderuar Austrinë për ndihmën në kuadër të procesit të integritimit në BE dhe arritjes së marrëveshjes eventuale me Serbinë. Ai ka thënë se Kosova

me përkushtim do t'i përmbushë kriteret për anëtarësim në BE dhe do të bëjë përpjekje serioze për arritjen e marrëveshjes me Serbinë. "Përkrahja e Austrisë dhe e shteteve të tjera anëtare të BE-së, si dhe përkrahja e vazhdueshme e ShBA-së për arritjen e marrëveshjes, janë vendimtare në këtë fazë përfundimtare të këtij procesi të vështirë, por të domosdoshëm", ka deklaruar Thaçi.

Flet për "Epokën e re", Pal Lekaj

Paralajmërimet për mocio



Ministri i Infrastrukturës nga partia Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, nuk u frikësohet paralajmërimeve të opozitës për mocion mosbesimi ndaj Qeverisë Haradinaj. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Lekaj ka thënë se këto pretendime të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) janë joserioze, duke shtuar se këtë refren ky subjekt politik e ka përsëritur prej ditës që Ramush Haradinaj është bërë kryeministër i vendit. Lekaj ka bërë me dije se nëse opozita do ta kishte shumicën në Kuvend, atëherë Qeveria do të dorëhiqej. Duke folur rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi, ai ka theksuar se Qeveria Haradinaj nuk pranon kompromise të reja në këtë proces. "Prandaj çdo kompromis që e kalon pakon e Ahtisarit, Qeveria Haradinaj e konsideron të dëmshëm", është shprehur Lekaj

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINE, 26 GUSHT - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, i ka vlerësuar joserioze paralajmërimet e opozitës se në muajin shtator do të ngrehë mocion mosbesimi ndaj Qeverisë. Ai ka thënë se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e ka përsëritur këtë refren prej se Ramush Haradinaj ka marrë detyrën e kryeministrit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se Qeveria nuk u frikësohet këtyre paralajmërimeve ngaqë, sipas tij, opozita nuk e ka shumicën në Kuvend. "Tashmë Qeveria Haradinaj është afër njëvjetorit që nga marrja e përgjegjësisë dhe pothuajse gjatë gjithë

këtyre muajve kemi dëgjuar të njëjtin refren të partive opozitare, e sidomos të LDK-së, që do të organizojë mocion mosbesimi. Prandaj, unë nuk i marrë shumë serioze këto deklarime dhe nuk frikësohemi nga rrëzimi i Qeverisë. Nëse opozita do ta kishte shumicën e Kuvendit, ne do të dorëhiqeshim nga pozita", ka thënë Lekaj. Ai nuk beson se dikush nga koalicioni qeverisës mund ta ndihmojë opozitën për rrëzimin e Qeverisë, ndonëse ka shtuar se vlerëson çdo mendim ndryshe brenda koalicionit qeverisës. "Nuk jemi nga ato parti që jemi të lidhur domosdoshmërisht me pushtetin, andaj çdo mendim ndryshe të ndonjë deputeti, qoftë nga

pozita apo opozita, do ta respektonim. Mendimi ndryshe është thelbi i demokracisë", është shprehur ai.

Lekaj, i cili është edhe nënkryetar i AAK-së, ka treguar për punët e mëdha që, sipas tij, i ka bërë kjo Qeveri. "Në ditët e para të qeverisjes kemi arritur ta zhblokojmë procesin e demarkacionit, duke bërë një marrëveshje të re, e cila garanton korrigjimin e kufirit nga marrëveshja e demarkacionit që ishte nënshkruar nga Qeveria Mustafa, zhblokim ky që qytetarëve të Kosovës ua dha rekomandimin pozitiv për liberalizim të vizave. Po gjatë kësaj qeverisje jemi duke punuar për një infrastrukturë më të mirë dhe zhvillim ekonomik të cilin

n ndaj Qeverisë, joserioze

besimi. Prandaj, unë nuk i marrë shumë serioze këto deklarime dhe nuk frikësohemi nga rrëzimi i Qeverisë. Nëse opozita do ta kishte shumicën e Kuvendit, ne do të dorëhiqeshim nga pozita.

"Epoka e re": Nëse vjen deri te votimi i këtij mocioni, kenë frikën se ndonjë deputet i PDK-së apo prej subjekteve të tjera të koalicionit qeverisës mund të votojë për rrëzimin e Qeverisë?

Lekaj: Nuk jemi prej atyre partive që jemi të lidhur domosdoshmërisht me pushtetin, andaj çdo mendim ndryshe të ndonjë deputeti, qoftë nga pozita apo opozita, do ta respektonim. Mendimi ndryshe është thelbi i demokracisë.

"Epoka e re": Një nga arsytet e opozitës për këtë mocion është se kjo Qeveri po qeveris dobët. Cili është qëndrimi juaj ndaj këtyre pretendimeve?

Lekaj: Kjo Qeveri ka filluar punën me intensitet të lartë. Pothuajse në çdo mbledhje të Qeverisë janë votuar dhjetëra vendime të cilat kanë qëndruar në sirtar me vite. Në ditët e para të qeverisjes kemi arritur ta zhblokujmë procesin e demarkacionit, duke bërë një marrëveshje të re, e cila garanton korrigjimin e kufirit nga marrëveshja e demarkacionit që ishte nënshkruar nga Qeveria Mustafa, zhblokim ky që qytetarëve të Kosovës ua dha rekomandimin pozitiv për liberalizim të vizave. Po gjatë kësaj qeverisje jemi duke punuar për një infrastrukturë më të mirë dhe zhvillim ekonomik të cilin e meritojmë, për një shëndetësi që të gjithë e duam dhe një arsim sa më cilësor. Këto ndryshime janë të prekshme për qytetarët. Këto ndryshime i di edhe opozita, por ne e dimë rolin e saj kritikues.

"Epoka e re": Opozita po frikësohet se ky koalicion qeverisës në fazën finale të dialogut me Serbinë rrezikon ndarjen e veriut.

Lekaj: Qeveria e Kosovës në këtë fazë të dialogut dëshiron që i gjithë spektri politik i Kosovës të jetë unik duke i vënë kushte të qarta përfaqësuesit të Kosovës në këtë dialog. Ne si Qeveri jemi kundër çfarëdo ndarje të Kosovës në këtë proces. Kosova kompromisin më të madh e ka bërë në procesin e Vjenës, gjegjësisht në pakon e Ahtisarit, prandaj çdo kompromis që e kalon këtë pako, Qeveria Haradinaj e konsideron të dëmshëm.

"Epoka e re": Presidenti i Kosovës edhe në Forumin Evropian në Alpbach e ka përmendur idenë për korrigjim të kufirit me Serbinë, duke ia bashkuar Kosovës Luginën e Preshevës. Si i sheh Qeveria këto pretendime të shefit të shtetit?

Lekaj: Sa i përket idesë së presidentit Thaçi për korrigjim të kufirit kjo duhet trajtuar në opinionin publik pa inate dhe si një ide të cilën shqiptarët

kanë vite që e kërkojnë. Çdo korrigjim i kufirit që shkon në të mirë të Kosovës do të ishte i mirëseardhur, mirëpo kjo nuk do të nënkuptonte që nga Kosova të shkëputej asnjë pjesë e saj.

"Epoka e re": Qytetarët e Kosovës janë në pritje të vendimit për liberalizim të vizave. A rrezikohet ky proces nga dorëheqja e ish-prokurorit special, i cili ka qenë duke i hetuar

listat e veteranëve të UÇK-së, meqenëse ai ka deklaruar se ka qenë i kërcënuar?

Lekaj: Kosova ka marrë rekomandimin pozitiv për liberalizimin e vizave dhe jemi në pritje që ky proces të mbyllet përfundimisht, prandaj dorëheqja e një prokurori të pagximshëm për kryerjen e obligimeve të veta ligjore nuk do të duhej të ndikonte në ndryshimin e vendimit të Parlamentit Evropian.

Peticion BE-së kundër ndarjes së Kosovës

PRISHTINË, 26 GUSHT (ER) - Getoar Mjeku, jurist nga Prishtina, ka nisur një petition drejtuar udhëheqësve të lartë të Bashkimit Evropian, në të cilin shprehet kundërshtimi i copëtimit, këmbimit të territoreve dhe ndarjes në vija etnike. Kjo letër drejtuar udhëheqësve të lartë të Bashkimit Evropian kërkon që Serbia ta njohë Kosovën dhe paralajmëron se presidenti Hashim

Thaçi nuk ka autoritet ligjor për të negociuar me Serbinë. Peticionin shqip dhe anglisht mund ta nënshkruajnë qytetarët e Kosovës dhe qytetarët e vendeve evropiane duke ndjekur këtë vjeggj: <https://www.change.org/p/president-of-the-european-council-serbia-ta-njohë-kosovën-jo-copëtimit-jo-ndarje-në-vija-etnike/> Letra thotë se vetë pavarësia e Kosovës është kompromisi

mes shqiptarëve dhe serbëve. Më tutje, rikujton se Serbia e ka pushtuar Kosovën pesë herë gjatë 150 vjetësh dhe kërkon që Beogradi ta njohë shtetin e Kosovës për t'i parandaluar konfliktet e ardhshme. Në fund peticioni do t'u dërgohet zyrtarëve të lartë të BE-së, përfshirë përfaqësuesen e lartë Federica Mogherini dhe komisionarin për zgjerim Johannes Hahn.




e meritojmë, për një shëndetësi që të gjithë e duam dhe një arsim sa më cilësor. Këto ndryshime janë të prekshme për qytetarët. Këto ndryshime i di edhe opozita, por ne e dimë rolin e saj kritikues", ka thënë Lekaj.

"Epoka e re": Z. Lekaj, opozita ka paralajmëruar se në muajin shtator do të iniciojë mocion mosbesimi ndaj Qeverisë Haradinaj. I frikësoheni këtij mocioni?

Lekaj: Tashmë Qeveria Haradinaj është afër njëvjetorit që nga marrja e përgjegjësisë dhe pothuajse gjatë gjithë këtyre muajve kemi dëgjuar të njëjtin refren të partive opozitare, e sidomos të LDK-së, që do të organizojë mocion mos-

Ideja për 'korigjimimin e kufijve', zhbërje e procesit të pavarësimit të Kosovës



Bilal SHERIFI

Muajt e fundit debati rreth dialogut me Serbinë është shtuar shumë, duke marrë një dinamikë dhe vëmendje publike që nuk e ka pasur deri para pak kohe. U tha se kjo do të jetë faza finale e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe, si e tillë, edhe do ta prodhojë marrëveshjen finale mes dy vendeve. Meqë me përjashtim të emërtimit "Fazë finale" askush nuk e kishte idenë se për çka do të flitet në këtë proces të dialogut, atëherë pashmangshëm debati u përqendrua rreth asaj se kush do të duhej ta udhëheqë këtë fazë të dialogut me Serbinë!

Kohët e fundit Hashim Thaçi, i cili përkundër insistimit të vazhdueshëm, herë publik e herë jopublik, nuk arriti ta marrë mbështetjen e nevojshme për ta udhëhequr dialogun, me qëllim të zëvendësimit të temës së debatit publik nëse është apo nuk është personi i duhur për ta udhëhequr dialogun, doli me idenë e "Korigjimit të kufijve" me Serbinë, në fazën e fundit të dialogut! Me këtë "ide të re", Hashim Thaçi arriti ta zhvendosë debatin aty ku desh, dhe çështja e përfundimit në këtë dialog u hesht tërësisht!

Për t'i fituar simpatitë e shqiptarëve të shtypur dhe të diskriminuar të Luginës së Preshevës, Hashim Thaçi përsëriste në çdo konferencë të organizuar kohët e fundit se, kinse, "Korigjimi i kufirit me Serbinë" nënkupton bashkimin e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me Kosovën. Ai në asnjë rast nuk tregoi se sipas marrëveshjeve sekrete që ka me Beogradin, cilat pjesë të Kosovës parashihihen t'i jepen Serbisë. Me gjithë kundërshtitë e mëdha që pati kundër idesë që vë në rrezik integritetin territorial të Kosovës, Hashim Thaçi jo vetëm se nuk u tërhoq nga qëndrimi i tillë, por ai këmbëngulë për të mbajtur gjallë këtë ide. Edhe pse nuk e dimë përmbajtjen reale të "Korigjimit të kufijve", ideja e tillë e kthen çështjen e përfunduar të Kosovës në pikën fillestare të propagandës serbe, që të konsiderohet si "problem që kërkon zgjidhje në mes serbëve dhe shqiptarëve". Përkundër asaj se mund të duket si diçka që tanimë e dinë shumicë

ca e atyre që janë marrë me historinë e Kosovës, në vazhdim të këtij shkrimi do të ndalem në disa momente kyçe të rrugëtimit politik të Kosovës, sepse është e vetmja mënyrë që na bën të qartë rreziqet e mëdha që i kanosen vendit tonë nga ideja e moçme serbe që aktualisht është trumbtuar nga Thaçi dhe Vuçiçi!

1. Karta e Kombeve të Bashkuara, si burim bazë i të drejtës ndërkombëtare, ia ngarkon Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara misionin e ruajtjes së paqes dhe sigurisë në botë. Sa i përket çështjes së Kosovës, në përputhje me misionin që ka, Këshilli i Sigurimit ndërmoi një varg aktivitete diplomatike, që nuk do t'i përmend për të mos e zgjeruar shumë temën që po shqyrtoj. Mjafton të përmend se marrëveshja për përfundimin e luftës në Kosovë është rezultat i një procesi politik të ndërmarrë nën patronazhin e Këshillit të Sigurimit.

2. Kështu, në Beograd, më 2 qershor 1999 u nënshkrua "Plani i Paqes", i përpiluar nga G8 dhe i mbështetur nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Përmes këtij "Plani të Paqes", Jugosllavia detyrohej t'i jepte fund menjëherë dhe në mënyrë të verifikueshme dhunës dhe represionit në Kosovë dhe ta fillojë tërheqjen e plotë dhe të verifikueshme të forcave të veta nga Kosova. Krahas kësaj marrëveshjeje, në Kumanovë, më 9 qershor 1999, përfaqësuesit e NATO-s nënshkruan "Marrëveshjen Ushtarako-Teknike", që përcaktonte modalitetet e tërheqjes së forcave jugosllave dhe vendosjen e forcave të mandatuara nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së (KFOR).

3. Pas nënshkrimit të "Planit të paqes" dhe "Marrëveshjes Ushtarako-Teknike", Këshilli i Sigurimit të OKB-së, më 10 qershor 1999, miratoi Rezolutën 1244 përmes së cilës përcaktohej korniza e pranisë civile dhe e sigurisë në Kosovë, deri në përcaktimin e statusit politik përfundimtar. Miratimi i Rezolutës 1244 nga ana e Këshillit të Sigurimit të OKB-së u dha vulën ndërkombëtare këtyre marrëveshjeve.

4. Një gjë duhet ta kemi të qartë: vendimet e Këshillit të Sigurimit, që zakonisht emërohen edhe me termin Rezoluta, janë vendime obliguese për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Vendimet që i imponuan Serbisë tërheqjen e forcave të veta ushtarake, policore dhe politike nga Kosova e që përmbledhen në Rezolutën 1244 janë vendime të rangut më të lartë të së drejtës

ndërkombëtare lidhur me paqen dhe sigurinë e kësaj pjese të Evropës. Me një fjalë, përmes këtyre akteve të instancës më të lartë të institucioneve ndërkombëtare iu dha fund luftës në Kosovë!

5. Përmes vendimeve të përfshira në rezolutën 1244, institucioni më i rëndësishëm i të drejtës ndërkombëtare përcaktoi praninë e forcës ndërkombëtare të sigurisë që do të vendoseshin dhe do të vepronin në Kosovë. Krahas forcës së sigurisë, që duhej ta garantonte pamundësimin e shpërthimit të konflikteve të armatosura, Këshilli i Sigurimit përcaktoi edhe praninë civile ndërkombëtare, që do ta mbështeste procesin e krijimit të një autonomie dhe vetëqeverisjeje përmbajtjesore deri në zgjidhjen përfundimtare të statusit politik të Kosovës.

6. Dhe, ashtu ndodhi. Për më shumë se pesë vjet rresht prania civile ndërkombëtare përgatiti institucionet politike të Kosovës që do të mund t'i udhëhiqnin bisedimet për statusin final të saj. Në seancën e 24 tetorit 2005, Këshilli i Sigurimit mbështeti raportin e përpiluar nga i dërguari special Kai Eide dhe u pajtua se përcaktimi i statusit final të Kosovës ishte i domosdoshëm. Në përputhje me këtë vendim, Martti Ahtisaari dhe Albert Rohani ishin të ngarkuar zyrtarë për t'i udhëhequr bisedimet mes Serbisë dhe Kosovës, duke përcaktuar edhe parimet mbi të cilat duhej të mbështeteshin bisedimet.

Më duket e rëndësishme të përsëris se në "Parimet orientuese të Grupit të Kontaktit" theksohet se "rregullimi i statusit të Kosovës duhet ta konsolidojë sigurinë dhe stabilitetin rajonal, duke garantuar që Kosova të mos kthehet në gjendjen e para marsit të vitit 1999. Çdo zgjidhje e njëanshme që rezultojn nga përdorimi i forcës nuk do të jetë e pranueshme. Nuk do të ketë ndryshime të territorit të tanishëm të Kosovës, që do të thotë se nuk do të ketë ndarje të Kosovës dhe se nuk do të ketë bashkim të Kosovës me ndonjë shtet tjetër apo me ndonjë pjesë të ndonjë shteti tjetër. Integriteti territorial dhe stabiliteti i brendshëm i fqinjëve regjionalë do të respektohen plotësisht".

Rezultati i këtyre bisedimeve dihet. Po përmend vetëm epilogun e tyre. Në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të datës 26 mars 2007, Ban Ki-mooni shtroi për shqyrtim "Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e

statusit të Kosovës", që ishte përgatitur nga Martti Ahtisaari dhe ekipi i tij. "Martti Ahtisaari kishte bindjen e fortë se ishin shterur të gjitha mundësitë që të gjendej një rrugëdalje e negociuar dhe e pranueshme nga të dyja palët. Vazhdimi i bisedimeve, në cilëndo formë qoftë, nuk do të mundësonte të dilej nga ky qorrsoak. Ka ardhur koha të rregullohet statusi i Kosovës!"

Në fund të raportit të vet, Martti Ahtisaari përfundoi se "duke shqyrtuar historinë e re të Kosovës dhe realitetin e tanishëm dhe duke zhvilluar negociatën me të dyja palët, kam arritur të përfundim se opsioni i vetëm i qëndrueshëm për Kosovën është pavarësia e saj. Fillimisht kjo pavarësi duhet të jetë e mbikëqyrur nga bashkësia ndërkombëtare".

7. Shpallja e pavarësisë së Kosovës bëri që Serbia dhe mbështetësit e saj ta shtrojnë çështjen në kuadrin e institucioneve më të larta të drejtësisë ndërkombëtare. Më 8 tetor 2008 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi rezolutën përmes së cilës kërkoi që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të japë mendim lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Konkretisht, kësaj gjykate iu kërkua t'i përgjigjej pyetjes: "A është shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare?"

Më 22 korrik të vitit 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë shpalli vendimin e vet se akti "i miratimit të deklaratës së pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, nuk e ka shkelur as të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, as Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit e as Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Prandaj, miratimi i kësaj deklaratë nuk ka bërë shkeljen e asnjë rregulle të aplikueshme të së drejtës ndërkombëtare".

8. Të gjitha aktet e të drejtës ndërkombëtare lidhur me Kosovën, duke filluar nga "Plani i paqes", "Marrëveshja Ushtarako-Teknike" dhe Rezoluta 1244, janë vendime që përbëjnë Traktatin ndërkombëtar për paqen në Kosovë. Vendimi i institucionit më të lartë të drejtësisë ndërkombëtare, Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e vulosi të drejtën tonë për shtet të pavarur dhe sovran.

9. Prandaj, hapja eventuale e negociatave të reja, të kamufluara si "Faza finale e bisedimeve" për të "Korigjuar kufijtë" me Serbinë, do ta zhbënte procesin e gjatë, të

mundimshëm dhe me plot sakrificë të pavarësimit të Kosovës.

Po e përsëris edhe një herë: në fund të udhëheqjes së bisedimeve në mes të Serbisë dhe Kosovës, i ngarkuari i Kombeve të Bashkuara, z. Martti Ahtisaari, deklaroi se "Vazhdimi i bisedimeve, në cilëndo formë qoftë, nuk do të mundësonte të dilej nga ky qorrsoak. Ka ardhur koha të rregullohet statusi i Kosovës".

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe legjitimitetit të aktit të shpalljes së kësaj pavarësie nga GjND-ja, njohjes ndërkombëtare të shtetit të pavarur të Kosovës nga shumica e shteteve të botës, hapja e bisedimeve të reja me Serbinë nuk do të thotë asgjë tjetër pos ta fusësh Kosovën në një qorrsoak të rrezikshëm me pasoja shumë të mëdha.

Për këtë arsye, mbështetja që po i bën Hashim Thaçi, nga pozita e presidentit të Kosovës, idesë serbe për t'i vendosur në tavolinë bisedimesh territoret shqiptare, është ideja më e rrezikshme për paqen dhe sigurinë e Ballkanit Perëndimor. Dhe më gjerë.

Fatqeqësisht, pas refuzimit absolut që iu bë në Kosovë idesë së vjetër serbe për ndarjen e Kosovës, të prezantuar si "Korigjim kufijsh", në vend se të tërhiqej nga qëndrimet e veta, Hashim Thaçi vazhdoi aventurën me partnerin e vet Aleksandër Vuçiçin për të kërkuar nga Vjena mbështetjen e BE-së dhe të ShBA-së për copëtimin e Kosovës!

Qëndrimi i fundit në Vjenë dëshmoi se Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiçi kanë të gatshëm planin për ta futur në kasaphane të re territorin e Kosovës. Siç u pa, Hashim Thaçi nuk tërhiqet nga kjo rrugë me shumë rreziqe për popullin e Kosovës dhe më gjerë.

Është koha e fundit që të gjitha forcat politike dhe institucionale të Kosovës të dalin me qëndrim të qartë se në përpjekjet për të vënë në tryezë bisedimesh integritetin territorial të Kosovës, Hashim Thaçi nuk përfaqëson askënd tjetër pos vetes. Është obligim kushtetues i çdonjërit prej nesh që t'i sensibilizojmë institucionet e BE-së dhe të ShBA-së se asnjë marrëveshje e nënshkruar në këtë drejtim nuk do të ketë vlerë për shtetin e pavarur të Kosovës.

Kosova dhe tërë rajoni kanë nevojë për paqe, stabilitet dhe zhvillim ekonomik. Çdo përpjekje për t'i kthyer në tavolinë bisedimesh çështjet tanimë të përfunduara inkurajon forcat reaktive dhe luftënxitëse në Serbi, për të mbajtur nën kërcënim të vazhdueshëm paqen dhe sigurinë në këtë pjesë të Evropës!

Kuvendi në shtator i rikthehet punës

PRISHTINË, 26 GUSHT - Nga muaji shtator Kuvendi i Kosovës pritet ta rifillojë punën pas pushimeve dhe pas një sesioni paraprak të vlerësuar si jo shumë produktiv për shkak të problemeve me vendimmarrje. Opozita ka paralajmëruar iniciimin e mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë edhe pse nuk e ka saktësuar nëse ka siguruar shumicën e votave të nevojshme, kurse nga pushteti po paralajmërohet dinamikë e re në punën e legjislativit, sidomos për miratimin e ligjeve me prioritet për vendin.

Ndërsa monitoruesit e punës së Kuvendit të Kosovës thonë se me fillimin e sezonit vjeshtor në këtë institucion duhet të ketë një organizim më të mirë të punës sesa në sesionin paraprak.

Albert Krasniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës ka thënë se miratimi i ligjeve me prioritet, por edhe çështja e një uniteti për dialogun politik në mes të Kosovës dhe Serbisë do të duhej të ishin temat e para për të cilat deputetët do të duhej të diskutonin. Ai ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Kuvendit i kanë mbetur në procedurë shumë ligje për të cilat kërkohet një përgjigje prej deputetëve se duhet të miratohen apo jo. "Prej ligjeve që janë më të rëndësishme janë ato të cilat e prekin sektorin e drejtësisë, siç është Ligji për gjykatat, për Këshillin Prokurorial të Kosovës, për Këshillin Gjyqësor, Kodin Penal,

Mbrojtjen e sinjalizuesve. Pra, çështje të cilat po e prekin çdo ditë jetën e qytetarëve. Së fundi po shohim edhe rastin e ndërhyrjeve që po bëhen nga politika në institucionin e gjyqësorit", është shprehur Krasniqi, duke shtuar se, përveç ligjeve që janë në pritje për shqyrtim e miratim, janë edhe disa marrëveshje ndërkombëtare të cilat priten të ratifikohen siç është ajo e IPA-s [fondeve të Instrumentit të Par-Anëtarësimit (IPA)] dhe Rasmus plus. Sipas Krasniqit, edhe në sezonin e ri të Kuvendit pritet që çështja e bisedimeve politike Kosovë - Serbi të jetë toptema e fillimit të punës së Kuvendit. "Besoj se dialogu do të jetë toptema me të cilën Kuvendi do të vazhdojë të merret dhe këtu shpresoj se Kuvendi do të marrë më shumë përgjegjësi dhe nuk do të lejojë që presidenti do të jetë ai i cili do ta marrë vetëm përsipër gjithë këtë proces pa një mbikëqyrje parlamentare dhe duke e anashkaluar rolin e Kuvendit, të kryeministrit, pra duke marrë kompetenca të cilat janë jashtë kompetencave të tij të përcaktuara me Kushtetutë", ka theksuar Krasniqi. Sipas tij, Kuvendi i Kosovës në sezonin e kaluar nuk ka punuar në bazë të agjendës së vet, por më shumë atij i kanë paraprirë debate për çështje të caktuara që janë zhvilluar në media gjë që, sipas Krasniqit, nuk do të duhej të ndodhte tash.

Kurse deputeti i Partisë



Demokratike të Kosovës, Zenun Pajaziti, ka pohuar për "Radion Evropa e Lirë" se puna në Kuvend dhe cilësia duhet të rritet dhe, siç shprehet ai, duhet të ketë një fokus më të madh në miratimin e ligjeve dhe monitorimin e zbatimit të tyre. Ai thotë se pozita dhe opozita duhet t'i kthehen seriozisht punës në Kuvend për miratimin e ligjeve cilësore. Kurse sa i takon debateve që mund të vijnë në Kuvend për zhvillimet aktuale, Pajaziti thotë se ato nuk mund të ndalen asnjëherë. "Mënyra e punës së Kuvendit tonë lë hapësirë që deputetët të merren edhe me tema jashtë rendit të ditës. Këto debate nuk do të ndalen kurrë. Mendoj se

nuk ka diçka të keqe nga këto debate. Shpesh debatet e tilla bëhen për shkak të agjendave politike të momentit. Çështja kryesore është të thellohem më shumë në ligje dhe vendime që duhet t'i marrë Kuvendi në përputhje me mandatin e tij", ka thënë Pajaziti.

Kurse Partia Socialdemokrate edhe gjatë ditëve të pushimit të Kuvendit kërkoi nga partitë e tjera opozitare ta mbështesin iniciativën e saj për thirrjen e një seance të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës për të diskutuar rreth procesit të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Shefi i Grupit Parlamentar i PSD-së, Dardan Sejdiu, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se

për të diskutuar për çështje të rëndësishme nuk duhet të pritet deri në muajin shtator, por ato duhet të diskutohen që sot. "Ky vend lëngon edhe sa i takon zhvillimit ekonomik e, që besa, na presin edhe diskutime goxha të vështira, pra zhvillimi ekonomik, sistemi i drejtësisë dhe një shtet i mirëqenies për të gjithë, një ndërtim i një sistemi social, i cili u ofron të gjithë qytetarëve barazi në trajtim shëndetësor, në kujdes social e skema të ndryshme", ka deklaruar Sejdiu.

Ndërsa deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës kanë paralajmëruar edhe iniciimin e një mocioni mosbesimi ndaj Qeverisë së Kosovës.

LB-ja: Reforma në drejtësi, e domosdoshme dhe urgjente

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 26 GUSHT - Lëvizja për Bashkim (LB) ka reaguar lidhur me listat e veteranëve të UÇK-së, korrupsionin dhe vetingun. Sipas LB-së, çështja e manipulimeve me listat e veteranëve është aferë e pastër korruptive. "Në fakt, këtu kemi të bëjmë me korrupsion masiv. Pasojat e këtij manipulimi masiv janë të jashtëzakonshme dhe të natyrale të ndryshme: e dëmtojnë buxhetin e shtetit, i dëmtojnë veteranët e vërtetë, e dëmtojnë rëndë demokracinë dhe besimin në institucione. Sa i përket buxhetit, ai dëmtohet në mënyrë direkte dhe jodirekte. Në mënyrë direkte përmes pagesës së, së paku, 39 milionë euro në vit, në emër të pensioneve për njerëz mashtrues, dhe në mënyrë jodirekte përmes shmangies nga pagesa e taksave nga ana e atyre

që punojnë nëpër kompani private, por nuk janë të regjistruar si të punësuar, që të mos e humbin mundësinë e marrjes së pensionimit", është thënë në reagimin e LB-së.

Sipas kësaj partie, kjo aferë dëmton edhe veteranët e vërtetë të luftës si në aspektin moral, po ashtu edhe në atë financiar. "Moral për shkak të stigmatizimit të statusit të veteranit, kurse financiar për shkak të kufizimeve buxhetore dhe shpërndarjes së këtyre mjeteve edhe tek mashtruesit. Duke qenë se një prej motiveve të përgjegjësve të këtij mashtrimi, përveç atij financiar, është edhe korrupsioni i votës së qytetarëve, është i pashmangshëm dëmtimi i madh i demokracisë në vend. Numri i madh i mashtruesve, shumëzuar me ndikimin e tyre në rrethin e tyre, bën që vullneti i votuesve të deformohet dhe të shndërrohet në mall. Kjo është



fatale për një demokraci", është thënë në reagimin e LB-së, duke shtuar se, megjithatë, ky nuk është rasti i parë dhe i vetëm i korrupsionit në vend. "Ky ishte rasti i cili, më fuqishëm se çdo tjetër, e nxori në sipërfaqe gjendjen e rëndë të

institucioneve të drejtësisë në vend. Duke qenë kështu, Lëvizja për Bashkim kërkon me ngulm nga të gjitha forcat politike dhe qytetarët që së bashku ta rrisim presionin për reforma të thella në drejtësi, me theks të veçantë për

miratimin e ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve, prokurorëve dhe policëve, që ndryshe njihet edhe si ligji i vetingut", është theksuar në reagimin e LB-së, parti kjo që drejtohet nga Valon Murati.

Ende gruri i pakorrur nëpër ara

Bazuar në të dhënat e marra nga terreni, rezulton se sivjet fushata e korrje-shirjeve të grurit ka dështuar si nga rendimentet, po ashtu edhe nga sipërfaqet që janë korrur sivjet me grurë

EPOKA ERE

Ismail REXHEPI

FERIZAJ, LIPJAN, 26 GUSHT - Edhe në këto ditë në terren shohim shumë sipërfaqe me grurë nëpër ara. Gruri që ende rri në arë pa u korrur është rrëzë magjistrale Prishtinë - Shkup, në fshatin Qallapek dhe afër

fabrikës së miellit në Smallushë të Komunës së Lipjanit. Gjithashtu, sipërfaqe të tjera të grurit në fshatin Babush i Muhaxherëve ishin të rrethuara nga uji. Po ashtu, ara të shumta me grurë të pakorrur ka edhe në fshatin Cërnillë të Komunës së Ferizajt, afër rrugëkryqit që shpie për në fshatin

Mirashë të kësaj komune. Edhe këtu disa prej bujqve kanë deklaruar se sipërfaqe jo të vogla të grurit në fshatin Cërnillë kanë mbetur pa u korrur për shkak të reshjeve të përditshme të shiut në afatin kur duhej korrur gruri. Kështu, tash ky grurë, edhe po të mos e pengojë lagështia, nuk ia vlen të korret, sepse kokrra e grurit veç është prishur dhe nuk e merr asnjë mulli. Edhe rendimentet do të jenë aq të ulëta sa që një hektar nuk prodhon 100 kilogramë grurë. "Edhe mundi dhe shpenzimet në mbjelljen e tij

sivjet kanë shkuar huq. Tash mendojmë që këto ara me grurë t'i bëjmë ugarë për mbjelljet e pranverës së ardhshme", kanë pohuar disa nga bujqit e fshatit Cërnillë të Komunës së Ferizajt. Gjithashtu, sipërfaqe të grurit që ende mrizon nëpër ara ka edhe në fshatrat Bujari e Llugaxhi të Komunës së Lipjanit. Edhe këtu bujqit kanë bërë me dije se këto sipërfaqe nuk do të korren se vetëm çka shtohen humbjet. "Kombajnën duhet paguar pa pikë rezultati", thonë banorët e këtyre

fshatrave.

Edhe pronarët e disa mullinjve kanë deklaruar se gruri që ende nuk është korrur nuk do ta pranojnë në mullinjtë e tyre, sepse ai tashmë është i prishur.

Bazuar në të dhënat e marra nga terreni rezulton se sivjet fushata e korrje-shirjeve të grurit ka dështuar me të madhe si nga rendimentet, po ashtu edhe nga sipërfaqet që janë korrur me grurë. Andaj, droja e qytetarëve se sivjet mund të ketë ngritje të çmimit të miellit dhe bukës është e arsyeshme.



Rritet eksporti nga Kosova për në Gjermani

EPOKA ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 GUSHT - Sipas Entit Federal Gjerman të Statistikave, Kosova në periudhën janar-qershor 2018 ka eksportuar mallra në Gjermani në vlerë prej 11 276 000 eurosh në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ku ka eksportuar 8 807 000 euro. Drejtoresha e Odës Ekonomike Gjermane-Kosovare (OEGJK), Nora Hasani, ka treguar se kjo odë në vazhdimësi ka ndihmuar firmat anëtare që ta shfrytëzojnë më mirë potencialin e tyre për eksport në Gjermani, duke dhënë kështu kontribut në uljen e deficitit të

lartë në bilancin tregtar të Kosovës me Gjermaninë. "Kosova ka potencial të madh për ta shumëfishuar eksportin në Gjermani. Këtë më së miri e ilustron statistikat e fundit të Entit Federal Gjerman të Statistikave, sipas të cilit, gjatë gjysmëvjetorit të parë 2018, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet rritje mbresëlënëse prej 28 përqindësh të eksportit për në Gjermani", ka theksuar Hasani, duke iu referuar të dhënave nga publikimi i fundit i Komitetit Lindor të Ekonomisë Gjermane. "OEGJK-ja përmes këshillimit për eksport, trajnimeve dhe aktiviteteve konkrete me asocia-



cionet partnere në Gjermani, mbështet në mënyrë të vazh-

dueshme kompanitë e Kosovës që kanë synim tregun gjerman", ka

shpjeguar Hasani.

Gjatë vitit 2017 OEGJK-ja ka trajnuar 374 përfaqësues të ndërmarrjeve anëtare dhe joanëtare përmes "Kurseve të promovimit të eksportit" në: procedura për standardizim dhe certifikim, menaxhim, qeverisje të korporatave, përgatitje për takime biznesi me biznes dhe marketing. Për shkak të kërkesës së madhe, këto trajnime vazhdojnë të ofrohen edhe në vitin 2018 dhe mbështeten nga Qeveria e Gjermanisë përmes bashkëpunimit ndërkombëtar gjerman në kuadër të projektit "Krijimi i punësimit përmes promovimit të eksportit".

Askush nuk i blenë hipotekat



Bankat komerciale që operojnë në Kosovë jo rrallëherë shpallin njoftime publike për shitje të veturave, tokave dhe pasurive të tjera të luajtshme apo të paluajtshme, hapësira banimi dhe hapësira afariste. Të gjitha këto janë hipoteka të cilat bankat komerciale në tregun e Kosovës i kanë vënë në shitje

PRISHTINË, 26 GUSHT - Shitja e hipotekave vjen si pasojë e mosarritjes së shlyerjeve të kredive ndaj bankave nga ana e kredimarrësve. Por, në tregun e Kosovës rrallëherë ndodh të blihet pasuria e lënë peng në banka. Hipoteka është një e drejtë reale që vihet mbi pasurinë e debitorit në dobi të kreditorit, për ta siguruar përmbushjen e një detyrimi. Sipas të dhënave të

Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, rreth 4.8 milionë euro është vlera e përgjithshme e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme në bankat komerciale në vend.

Ekspertë për çështje financiare dhe përmbarues në Kosovë konsiderojnë se problemi i mosshitjes së pronave të lëna hipotekë ka të bëjë me traditën e qytetarëve që

mos të blihet pasuria, sipas tyre, me probleme.

Përmbaruesi Fadil Hoxha, njëherësh ish-zëvendëskryetar i Bordit Ekzekutiv të Odës së Përmbaruesve Privat, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se qytetarët hezitojnë t'i blejnë pronat e lëna hipotekë. Ai ka treguar se interesi mi për këto pronat nuk mungon, por blerje nuk ka. "Ka pasur disa herë interesim, në fakt kanë ardhur qytetarët, janë interesuar për çmimin e këtyre pronave, nuk kanë diskutuar a kanë probleme, pavarësisht asaj se ne i tregojmë se probleme ligjore nuk ka, pasi ligji ekziston për një çështje të tillë, por pastaj nuk janë paraqitur", ka thënë Hoxha.

Edhe ekspertë për çështje financia-

re theksojnë se blerja e hipotekave nga palët e treta në të shumtën e rasteve dështon për shkak të traditës së qytetarëve.

Hashim Rexhepi, ish-gubernator në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se, pavarësisht prej faktit se sistemi bankar në Kosovë është i qëndrueshëm dhe kreditë joperformuese janë në nivel të ulët, mosshitja e pronave hipotekë është problem evident dhe mjaft kompleks. "Në rastet kur bankat detyrohen t'i shesin pronat e ndryshme, ende është i pranishëm mentaliteti nga e kaluara, që mos të blihen pronat e të afërme të tyre. Në këtë drejtim nevojitet një vetëdijesim më i madh sepse prona është pronë dhe është e

drejtë e bankës që ta shesë. Unë mendoj se kjo çështje gradualisht do të avancohet dhe si problem do të zgjidhet. Por, në mungesë të blerësve potencialë, këto pronat në të shumtën e rasteve detyrohen t'i blejnë vetë bankat komerciale. Zakonisht në 99 për qind të rasteve bankat i blejnë dhe bëhen pronarë të tyre", ka thënë ai. Sidoqoftë, sipas shoqërisë civile që merren me këtë çështje, institucionet financiare që operojnë në vend zhvlerësojnë në masë të madhe vlerën e patundshmërisë së lënë si hipotekë apo kolateral në bankat komerciale. Vlera e kredive të lëshuara nga 10 bankat komerciale ka arritur në rreth 2.6 miliardë euro, me normë të interesit 6.5 për qind.

'Trepça' në gjendje të rëndë, punëtorët mund të mbesin pa paga

PRISHTINË, 26 GUSHT - Gjendje mjaft e rëndë është krijuar në kombinatin metalurgjik "Trepça", ku aktualisht ndërmarrrja po shënon rënie të mëdha të prodhimit. Kjo ndërmarrrje, e cila dikur ka qenë gjigante, aktualisht nuk po arrin t'i sigurojë as pagat për 1 300 punëtorët.

Ish-drejtori i përgjithshëm në "Trepçë", Halil Qela, i cili aktualisht është drejtor i flotacionit në këtë ndërmarrrje, ka thënë në një intervistë për "KosovaPress" se

gjendja aktuale nuk është e mirë. Sipas tij, nëse nuk bëhet një zgjidhje e shpejtë dhe e drejtë prej Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, përkatësisht e Qeverisë, do të ketë rrezik në këtë muaj për sigurimin e pagave për punëtorë, e mos të flitet, siç ka thënë ai, për ekzistencën e "Trepçës". Ai ka folur edhe për minierat në veri që, sipas tij, ato janë të ndara dhe nuk menaxhohen nga pjesa e menaxhmentit në jug.



Kosova përkujton Nënë Terezën në 108-vjetorin e lindjes



PRISHTINË, 26 GUSHT - Emri i Nënë Terezës është letërnjoftimi i çdo shqiptari në botë, pasi bota nuk njih shqiptar tjetër më të famshëm se ajo. Kështu u tha të dielën në shënimin e 108-vjetorit të lindjes së Shën Terezës, ku është bërë edhe promovimi i librit "Familjet katolike

shqiptare në Shkup" të autorëve Skënder Asani, Albert Ramaj dhe Natasha Didenko dhe ekspozita dokumentare "Jeta përmes kujtimeve". Me këtë rast, ministri i Infrastrukturrës Pal Lekaj, ka lavdëruar punën e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve që ka

botuar këtë libër në ditëlindjen e Shën Terezës. Ai ka thënë se më e pakta që mund të bëjnë për një person që jetën ia fali dashurisë për të varfrit, të sëmurët është t'ia festojnë ditëlindjen. "Emri i Nënë Terezës është letërnjoftim i çdo shqiptari në botë", ka thënë ministri Lekaj, duke shtuar se bota

nuk njih shqiptar tjetër më të famshëm se Nënë Tereza. Ndërkaq Don Lush Gjergji nga Ipeshkvia e Kosovës ka thënë se sot shqiptarët festojnë ditëlindjen e një motre të madhe siç është Nënë Tereza. Drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve dhe një

nga tre autorët e librit, Skender Asani, u shpreh se Shën Tereza ka lënë pas vetes mësimin më të mirë se, përkundër që u bë nënë e gjithë botës, mbeti nëna kombëtare e shqiptarëve. Ai ka thënë se shqiptarët janë komb me fat që e kishin një Nënë Terezë, kurse ka pohuar se shqiptarët shkupjanë janë dyfish të nderuar që, përveç lidhjes etnike, e kanë edhe lidhjen geografike.

Edhe presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka ndarë një dedikim me rastin e 108-vjetorit të lindjes së humanistes shqiptare Shën Tereza. "108 vjet më parë u lind Gonxhe Bojaxhiu, gruaja e madhe shqiptare, që u bë misionare dhe humaniste në përmasa botërore - Nëna Tereza, e shpallur Shenjtore nga Selia e Shenjtë, Vatikani. Ne mburremi me shpirtin human të Shën Terezës, me përkushtimin e saj për njerëzit pa mbështetje, në nevojë, për qeniet njerëzore që meritojnë dashuri dhe trajtim dinjitoz, pavarësisht gjendjes sociale dhe shëndetësore", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Nobelista shqiptare Gonxhe Bojaxhiu - Nëna Tereza ka lindur më 26 gusht 1910 në Shkup. Ajo tërë jetën e saj ia kushtoi çështjes së bamirësisë, duke i ndihmuar familjet e varfra dhe personat e sëmurë. Nëna Tereza ndërroi jetë më 5 shtator 1997. Për vlerat e saj jetësore, Nëna Tereza nga Kisha e Shenjtë në Vatikan u shpall Shën Tereza.

Gjendja e sigurisë në Mitrovicë, e qetë

MITROVICË, 26 GUSHT (ER) - Përfaqësuesi i stacionit jugor të policisë në Komunën e Mitrovicës, Qazim Ahmetaj, ka thënë se situata në këtë qytet është e qetë. Në mbledhjen e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), e cila është drejtuar nga nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, Ahmetaj ka folur edhe për riintegrimin e të kthyerve nga Siria dhe Iraku dhe familjarëve e tyre. Ai ka thënë se këta persona janë larguar nga Kosova më shumë për shkaqe ekonomike, për të shtuar se ata persona nuk paraqesin ndonjë rrezik për

vendin tonë. Ahmetaj ka thënë se këta persona kanë dalë më shumë duke menduar se do të gjejnë një jetë më të mirë. Shqipe Mjekiqi, konsulente në ATRC, para të pranishmëve ka folur për projektin për të cilin parashihet të sigurohen 2.5 milionë dollarë me qëllim të bashkëpunimit me personat të cilët janë kthyer nga Siria dhe Iraku, në mënyrë që të parandalohet ekstremizmi dhe radikalizmi. Ajo ka thënë se në qytetin e Mitrovicës janë 39 persona, në mesin e tyre ka edhe gra e fëmijë që kanë shkuar në këto shtete.



Zgjerimi i rrugës Prishtinë - Gjilan do të përfundojë deri më 10 shtator

PRISHTINË, 26 GUSHT (ER) - Ministri i Infrastrukturrës, Pal Lekaj, të dielën ka vizituar punimet në zgjerimin e rrugës N25.2, në hyrje të Prishtinës, e cila, sipas ministrit

Lekaj, do të përfundojë deri më 10 shtator të këtij viti. Ministri Lekaj ka thënë se ky është edhe një nga projektet për rimëkëmbjen dhe modernizimin

e infrastrukturës në tërë vendin. "Asfaltimit të rrugës së 'Gorenjes', njëra prej shumë projekteve për rimëkëmbjen dhe modernizimin e infrastrukturës në mbarë vendin

që janë pjesë e rjetit tonë ndërrurban, po i vjen fundi. E tëra do të përfundojë deri më 10 shtator", ka shkruar ministri Pal Lekaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Këndvështrim nga Prizreni

Treni për Bruksel



**Shkruan: MSC.
Ramadan BARALJU**

Në Prizren shpesh dëgjon muhabete me nostalgji se si kanë hipur në tren në Prizren dhe kanë zbritur në Vjenë para do kohe. Sot treni nuk shkon për Prizren dhe askund tjetër. Shinat e trenit janë ngulfatur nga ndërtesa që janë shumë në numër dhe të larta, por të paarrishme për shumicën e qytetarëve. Prishja e hekurudhës dhe pamundësia e udhëtimit për në Vjenë nga Prizreni, ngjason me rrugëtimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor në proceset integruese në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Përderisa shtetet e zhvilluara punojnë për të rritur mirëqenien e qytetarëve të tyre edhe më shumë, shtetet e Ballkanit Perëndimor ende orvaten në problemet e moçme, që vazhdimisht u kanë sjellë varfëri. Deri te kjo gjendja ka ardhur pasi që në Ballkan me shekuj janë ndeshur interesat e Lindjes dhe Perëndimit, ndërsa popujt ballkanas kanë mbetur në mjegullën që është krijuar dhe nuk po mund të dalin, edhe pas shumë mësimëve. Në opinionin tim, zgjidhja përfundimtare e këtyre problemeve ballkanike është integrimi i plotë në Bashkimin Evropian dhe në NATO dhe në miqësi të plotë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Por sa do zgjasë ky proces dhe a kemi shumë kohë për të pritur? Kosova është në pritje të konfirmimit të rekomandimit të Komisionit Evropian në Parlamentin Evropian dhe në Këshillin e BE-së sa i përket liberalizimit të vizave. Duket që ky propozim do të kalojë pozitivisht për kosovarët, nëse nuk e prishim punën vet ne, në momentin e fundit, siç ndodhë shpesh, pasi këso kulture politike kemi kultivuar deri më tani. Në këtë funksion, duhet të adresohet sa më parë nga organet e drejtësisë, procesi i hetimeve për veteranët, dhe në këtë proces politika nuk duhet të ketë dorë. Për shkak të këtij rasti, mund ta humbim mundësinë që të lëvizim lirshëm.

Çfarë po ndodh në Bashkimin Evropian

Qytetarët e shteteve të Bashkimit Evropian në vitin e ardhshëm do t'i drejtohen kutive të votimit në

zgjedhjet që do të organizohen për Parlamentin Evropian. Mandati i përbërjes VIII të Parlamentit Evropian përfundon më 18 prill 2019. Në një votim të drejtpërdrejtë më 23-26 maj, qytetarët në 27 shtete anëtarë të BE-së do të zgjedhin 705 deputetë. Deri më tani PE i kishte 751 deputetë nga 28 shtete anëtarë, mirëpo pas BREXIT, PE do të tkurret.

Deri më tani PE ka pas qëndrim shumë konstruktiv dhe mbështetës në raport me shtetin e Kosovës dhe proceset integruese të Ballkanit Perëndimor. Tani, frika kryesore është rritja e euroskeptikëve dhe partive populiste dhe mundësia e rritjes së fuqisë së tyre edhe në PE pas zgjedhjeve 2019. Por, këto parti janë të aftë të formojnë një forcë parlamentare e vetme koherente, kjo mbetet për tu parë. Ajo që dihet deri më tani është se dallimet mes tyre në shtetet të ndryshme evropiane, gjithnjë po zvogëlohen. Disa nga partitë euroskeptike dhe populiste e kanë ndërruar diskursin. Ato më nuk shprehën më kundër Bashkimit Evropian, por janë për reforma rrënjësore në mënyrën e vendimmarrjes brenda unionit dhe në shumë aspekte tjera. Madje është përmendur edhe mundësia e shuarjes së Komisionit Evropian, organ i cili pothuajse vendos për gjithçka brenda BE-së. BE është projekt i elitave evropiane. Rritja e ndikimit të partive populiste mund të ketë efekt negativë për shumë çështje. Po ashtu ekziston një iniciativë për organizim kundër stabilizimit aktual në BE, duke marrë modelin amerikan. Jo vetëm që populistët janë gati të prishin konstolacionin aktual të forcave në parlament, por një valë e re e partive transnacionale pak të vërejtura po shfaqen gjithashtu. Të dy kërcënojnë partitë kryesore politike që kanë mbajtur historikisht monopolin në projektin evropian. Evropa mund të jetë në prag të një forme më transnacionale të demokracisë, e cila është e polarizuar rreth pozicioneve themelore pro dhe anti BE. Grupi më i madh politik në PE është Partia Popullore Evropiane - EPP e djathtë, e cila mban 217 nga 751 vende, e ndjekur nga Aleanca Progresive e Majtë e Socialistëve dhe Demokratëve-SD, e cila aktualisht mban 189 vende. Parlamenti gjithashtu përfshin Aleancën e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën-ALD, Konservatorët dhe Reformistët Evropianë dhe disa koalicione të tjera më të vogla.

Nëse ndodhë një polarizim i tillë në BE, qëndrimet e forcave të reja që pretendojnë të fitojnë shu-

micën dihen dhe forcimi i tyre mund të shuaj shpresat e kosovarëve për lëvizje të lirë por mund të ju rikthejë vizat edhe shteteve të rajonit nëse vazhdojnë të sjellin telashe për BE-në. Po ashtu rrugëtimi për integrim në BE-në i shteteve të Ballkanit Perëndimor mund të zgjatet.

Është momenti i fundit që të bindim opinion evropian se shtetet e Ballkanit Perëndimor janë të gatshëm për integrim të plotë dhe se nuk do të sjellin telashe me integrimin e tyre, porse do të jenë vlerë e shtuar në këtë projekt mbi nacional. Këtë e tha të shtunën në Forumin Evropian në Alpbach të Austrisë edhe Presidenti i këtij shteti. Alexander Van der Bellen ka kërkuar nga Kosova dhe Serbia që të arrijnë marrëveshje brenda këtij viti. Kjo sipas tij duhet të ndodhë për shkak të zgjedhjeve të reja që ndodhin në BE në vitin e ardhshëm dhe kjo është periudha kur "treni ndalet".

E çka do të ndodhë nëse nuk e shfrytëzojmë trenin e fundit për të shkuar në Bruksel.

Largimi ose zgjatja e rrugës për në BE për shtetet e Ballkanit Perëndimor do të thotë krijimi i terrenit të përshtatshëm për agjendat ruse dhe të aleatëve të tyre në këtë hapësirë.

Ditë më parë Foreign Affairs publikojë një tekst, se "Si mund të luftojnë demokracitë kundër pushtetit autoritar". Aty theksohet se në mbarë botën, qeveritë autoritare po ndërhyjnë me institucionet e shoqërive demokratike në mënyra që nuk do të ishin të paimagjinueshme edhe gjatë Luftës së Ftohtë. Universitetet, kompanitë mediale, institutet hulumtuese, studiomet e filmit, muzetë, shtëpitë botuese dhe çdo aspekt i procesit politik po vihen në shënjestër nga ndikimi i jashtëm. Kjo lloj force e mprehtë është aq efektive, sepse institucionet në mjediset demokratike janë të hapura për botën e jashtme dhe në këtë mënyrë janë të prekshme ndaj manipulimit të huaj. Politikëbërësit brenda demokracisë duhet të përballen me sfidën e refuzimit të ndikimit të jashtëm, ndërkohë që mbështesin vlerat esenciale demokratike.

Kosova si demokraci e re dhe në konsolidim e sipër është shumë e ekspozuar ndaj këtyre ndërynjoreve të jashtme.

Afrimi i Kosovës dhe shteteve të tjera të Ballkanit Perëndimor me Evropën dhe integrimi përfundimtar i tyre në BE, do të thotë largimi përfundimtar i ndikimit Rus në këto shtete. Sa është e interesuar Rusia për këtë perspektivë, kjo çështje nuk do koment. Rusia vazhdimisht ka

luajtur dhe po luan me forcat nacionaliste në Serbi, Mal të Zi, Maqedoni dhe në BiH, duke shpresuar që të ngadalësojë rrugëtimin e këtyre shteteve për në BE dhe në NATO. Në Mal të Zi i dështoi tendenca për destabilizim, po ashtu edhe në Maqedoni, ndërsa ndikimin ende e ka në Serbi dhe në Republika Serbska, përmes tyre pretendo ta zgjerojë edhe në rajon.

Tani ekziston rezikshmëri që në të ardhmen Rusia të përdorë prezencën dhe ndikimin e madh që kanë shtete të tjera euro-aziatike që e po rrëshqasin në regjime diktatorial dhe po largohen nga aleancat perëndimore dhe që janë mjaftë prezentë në rajon, sidomos në Shqipëri dhe Kosovë. Shtete larg me amerikanët dhe evropianët ndërsa të afërt me rusët dhe serbët, nuk mund të jetë miq të besueshëm dhe të qëndrueshëm me shqiptarët. Shtetet e Ballkanit

Perëndimor, sidomos Kosova dhe Shqipëria duhet të jenë të vëmendshme për rreshtimet në këtë kohë të ndërrimit të raporteve në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe krijimit të aleancave të reja. Duhet të bëjmë një mburojë për ndikimet që mund të vijnë nga shtetet që historikisht nuk kanë mbajtur qëndrim në favor tonin.

Të gjithë duhet t'i kryejmë me përpikëri detyrat e shtëpisë në mënyrë që ta zëmë trenin e fundit për lëvizje të lirë dhe për integrim të plotë në BE dhe NATO. Duhet të zëmë trenin e fundit për Bruksel dhe mos ta katandisim trasenë siç kanë bërë me hekurudhën duke i pamundësuar lëvizjen trenit për Prizren. Vitin e ardhëm treni mund të ndalet!!!

(Autori punon në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren. Qëndrimet në këtë tekst janë personale)



Bekim Jashari përkujton dëshmorin Ismet Rrahmani

Skenderaj, 26 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, e ka kujtuar dëshmorin e kombit Ismet Rrahmani në 20-vjetorin e rënies. "Të lumtë ata që dhanë jetën për lirinë! Të lumtë ata që fituan respektin e kombit shqiptar, përjetësisht! E kujtojmë me respekt të veçantë dëshmorin e kombit, heroin e luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ismet Rrahmani, në 20-vjetorin e rënies për liri dhe pavarësi të vendit! Lavdi e përjetshme!", ka shkruar Bekim Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".

BACA ADEM DEMAÇI

Selatin NOVOSELLA

Derisa po e ngushëlloja djalin e Bacë Adem Demaçit, Shqiptarin, për vdekjen e babait, dhjetë minuta pas pushimit të zemrës së madhe të Bacit, ai më tha: "Baba vdiq i qetë!" Të njëjtat fjalë i tha edhe në mbledhjen përkujtimore, në Kuvendin e Kosovës, më 27 korrik 2018. Gjatë vizitave të panumërta për kryeshëndosh, disa herë e përsëriti Shqiptari se "Baba vdiq i qetë!"

1.

Si të mos vdiste Bacë Adem Demaçi i qetë kur, në moshën 20-vjeçare, në vitin 1956, kishte folur dhe shkruar kundër dy zezonave që po përjetonte Kosova në vitet e '50-ta, aksionin kriminal për grumbullimin e armëve prej shqiptarëve dhe përndjekjen e shqiptarëve, me dhunë, për në Turqi. I cili, gjatë gjyqit të parë, në vitin 1958, para Gjyqit të Qarkut, në Prishtinë, deklaronte: "Nëse Serbia dhe Jugosllavia vazhdojnë me këtë politikë kundër shqiptarëve nuk do të ketë paqe në Jugosllavi. Nëse Serbia vazhdon me këtë politikë, do të bëhet shkaktare e shkatërrimit të kësaj Jugosllavisë dhe, në fund, do të mbetet edhe pa Kosovën".

Kush e kishte këtë mendje historike-paravajtëse si Baca Adem? Zhvillimet e më vonshme vërtetuan, plotësisht, këtë mendim lapidar të tij. Nuk pati paqe në Jugosllavi. U shkatërrua Jugosllavia dhe Serbia mbeti pa Kosovën.

2.

Si të mos vdiste Bacë Adem Demaçi i qetë kur, në vitin 1963, në kushte kurrëfare, formoi organizatën e njohur atdhetare Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, (LRBSH) së bashku me Fali Greçevcin, Zeqir Gërvallën, Azem Bqirin, Ahmet Haxhiun etj. Neni i parë i Statutit të kësaj organizate thoshte: Qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë është sigurimi i të drejtës për vetëvendosje deri në shkëputje për viset e banuara me shumicë prej shqiptarëve të cilët gjenden ende nën administrimin e Jugosllavisë, d.m.th., qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë është çlirimi i krahinave shqiptare, të aneksuara prej Jugosllavisë dhe bashkimi i këtyre krahinave me nënën e vet Shqipërinë. LRBSH-ja, për një kohë të shkurtë, formoi Komitetet në Prishtinë, në Mitrovicë, në Pejë, në Gjakovë, në Gjilan, në Shkup dhe në Stamboll. Pas shkrimit të

Programit dhe Statutit të LRBSH-së, nga Adem Demaçi dhe Ramadan Shala, në Pejë, në shkurt 1963; pas ngritjes së qindra flamujve kombëtar në shumë qytete të Kosovës; pas shkrimit të parullave në shumë vendbanimi të Kosovës "DUAM LIRI!", "RROFTË SHQIPËRIA!", "POSHTË TITO!", "RROFTË LRBSH-ja!" etj., dekonspirohet kjo organizatë dhe pasojnë burgosjet masovike të anëtarëve të saj. Adem Demaçi, në gjykimin e dytë, në vitin 1964, dënohet së bashku me Sabit Ratkocerin, Hazir Shalën, Selahudin Dacin, Azem Beqarin, Abdyl Lahun, Ahmet Haxhiun, Xhefer Mahmutxhikun, Dibran Bajraktarin, Sabri Novosellën, Tefik Sahitin dhe Nijazi Strajën. Baci gjykohej me 15 vite burg të rëndë.

3.

Si të mos vdiste Bacë Adem Demaçi i qetë kur, pas lirimimit nga burgju i dytë, më 8 qershor 1974, ishte shndërrua në simbol të bashkimit kombëtar. Andaj, Lidhja e Komunistëve të Kosovës dhe Serbisë si dhe UDB-ja nuk e ndienin veten të sigurt po të mos ishte ai, përsëri, prapa grilave. Vetëm kështu ata mund ta ndalnin maratonin e lirisë së Kosovës, Adem Demaçin. Ai burgoset, herën e tretë, më 6 tetor 1975, së bashku edhe me 18 veprimtarë të tjerë: Skënder Kastratin, Hetem Bajramin, Hasan Dërmakun, Osman Dumoshin, Rexhep Malën, Selatin Novosellën, Ilaz Pirevën, Fatmir Salihun, Xhavit Dërmakun, Sherif Masuricën, Sami Dërmakun, Zijadin Spahiun, Isa Kastratin, Ahmet Hotin, Nijza Korqën, Irfan Shaqirun, Ilmi Ramadanin dhe Nazim Shurdhanin.

Deri sa herën e parë dhe të dytë Baca Adem ishte arrestuar për veprimtari atdhetare-çlirimtare, gjykimi i tretë ishte, kryekreje, proces i montuar politikë, ashtu siç dinin të organizonin vetëm sistemet fashiste, diktatoriale dhe komuniste. Kësaj radhe synohet të burgosej ideja e Adem Demaçit, vizioni politik i Adem Demaçit, misioni historike i Adem Demaçit. Koha do të dëshmojë të kundërtën. Siç thoshte një gazetë kroate e kohës: "Pas burgosjes së tretë të Adem Demaçit nga Serbia dhe Jugosllavia, ai do të jetë udhëheqës i dyfishtë për shqiptarët e Kosovës dhe Jugosllavisë: lider organizativ dhe shpirtërorë".

Në fund të këtij gjykimi, në Gjyqin e Qarkut të Prishtinës, në janar të vitit 1976, ai do të

deklarojë në fjalën përfundimtare para gjyqit: Kësaj radhe nuk kam arritur të veproj kundër pushtetit serb dhe jugosllav. Shumicën e këtyre djemve, me të cilët po na gjykoni së bashku, nuk i njoh. Por, sa i përket bindjeve të mia politike, po ju them se: deri sa Kosova dhe viset tjera shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia nuk çlirohen dhe nuk bashkohen me atdheun tonë - Shqipërinë nuk do të ketë paqe në rajon!

Përsëri dënimi maksimal, 15 vite burg të rëndë, i rezervuar për armikun numër një të pushtetit jugosllav.

4.

Si të mos vdiste Bacë Adem Demaçi i qetë kur, pas lirimimit të tretë nga burgju, në prill të vitit 1990, në pyetjen e një gazetari të huaj - si po e gjente Kosovën pas 15 viteve, deklaronte: Kosovën po e gjej të tërën në këmbë. Po e gjej ashtu siç e kam ëndërrua tërë jetën!

Në kohën kur po formoheshin shumë parti politike, dhe kur i propozojnë të formonte edhe ai parti, iu përgjigjet: "Këto parti politike që i kemi janë të mjaftueshme për një popull rreth 2 milion. Dhe, çka është më e rëndësishme, po të formojë porti dikush do të vinte në partinë time dhe, kështu, do të dobësoheshim. Andaj, vetëm vazhdoni me veprimtarinë tuaj e mos u ndalni. Kurrë mos harroni: Serbia e ka shumë seriozisht, dhe ne duhet të sillemi seriozisht në rrethanat e reja. Lëvizja paqësore, vazhdonte Baca Adem, është përparësi e jona. Por, kjo lëvizje duhet të jetë e organizuar mirë, e koordinuar fuqishëm, të jetë lëvizje paqësore aktive, e jo të presim se do të ndodhë mrekullia".

Dilemat e shtruar nga individë dhe liderë të partive të shumta, gjatë viteve të '90-ta, se nuk duhet të jepet mundësia të angazhoheshin në jetën politike ish-udhëheqësve të sistemit, qofshin ata të strukturave partiake apo qeveritare, Adem Demaçi, deklaronte:

Të gjithë ata që duan ta japin ndihmesën e tyre për çlirimin e Kosovës duhet t'iu jepet mundësia. Edhe Ilijaz Kurteshit, edhe Mahmut Bakallit, edhe Azem Vllasit. Duhet të jemi së bashku. Aq më tepër vazhdonte Adem Demaçi - këta, sot, nuk po lypin të jenë udhëheqës, të jenë në krye të partive politike, as të na i zënë këto karrika të shkreta që i kemi zënë!

Kështu, Baca Adem, po dëshmonte edhe një herë, për të satën herë, se mbi çdo gjë e kishte lirinë e Kosovës.



5.

Si të mos vdiste Bacë Adem Demaçi i qetë kur, më 17 janar 1994, duke shkruar sesi do të duhej të ishte Heroi i kohës sonë, thoshte: - Heroi i sotëm nuk heziton që ta verë veten në provat më të vështira të jetës dhe i njeh të tjerët gjatë krijimeve krijues.

- Heroi i sotëm u reshtet konfrontimeve me të tjerët, mirëpo nuk ndahet nga rruga për të cilën është i bindur se është e drejtë.

- Heroi i sotëm e ruan shëndetin për të krijuar, krijon për të ndër-tuar rrugën e lumturisë së përgjithshme.

- Heroi i sotëm përbuzë pozat dhe nuk fyhet kur e përbuzin.

- Heroi i sotëm bashkëpunon me të gjithë ata që janë seriozë

dhe nuk janë prekur nga ambicie të prishura.

- Heroi i sotëm nuk manipulon me të tjerët, por as nuk lejon që të manipulohet nga të tjerët.

- Heroi i sotëm nuk dëshiron që ta shesë lirinë e vet për kurrfarë postesh e kolltukësh.

- Heroi i sotëm nuk e gënjen popullin e vet, sepse beson që edhe populli nuk ka nevojë për heronj të rrejshëm.

Pa dyshim, ky është autoportreti më besnik që ka bërë Heroi Adem Demaçi, qoftë edhe kundër dëshirës së tij.

6.

Si të mos vdiste Bacë Adem Demaçi i qetë kur, edhe një herë, me 99 plagë në trup dhe në shpirt, si Gjergje Elez Alia i legendave, po i përgjigjej burisë

VDIQ I QETË



së luftës, për të zënë vendin ku po ia caktonte momenti historik i Kosovës - si Përfaqësues i Përgjithshëm Politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ideatori dhe projektuesi i lirisë së Kosovës, Bacë Ademi, herë ishte në Zyrën e tij në qendër të Prishtinës, herë ishte në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, herë ishte në zonat Operative të luftës, herë ishte në takime me gazetarë, ambasadorë dhe diplomatë nga të gjitha anët e botës.

Ai, duke qenë gjithnjë vetvetja, do të japë këshilla, vërejtje, propozime dhe ide sesi të shtyheshin proceset politike dhe ushtarake më tutje, duke mos u kuptua, ndonjëherë, drejtë sa duhej. Ai, si gjithnjë i veçantë dhe i papërsëritshëm, nuk do të

pajtohet me disa qëndrime as të diplomatit Dinzbir, as të ambasadorit Hill, as të Holbrukut, as edhe të zonzjës së madhe Olbrajt. Holbruku, me një rast, kishte deklaruar, pas një takime ne Bacën Adem, se: me të gjithë ata me të cilët po bisedojmë në Kosovë po mirremi vesh disi, vetëm me Adem Demaçin assesi nuk mund të kuptohemi!

Ndërsa Sekretarja e Shtetit, Zonja Olbrajt, në Kujtimet e saja, thotë: - Demaçi ishte një nationalist i vjetër kosovar, njëri prej atyre që i bënin presion Thaçit të ruante qëndrimin më të ashpër të mundshëm...

Demaçi më tha: - Ne nuk do të heqim kurrë dorë nga ëndrra jonë për të qenë të lirë.

Unë iu përgjigja: - Propozimi im

nuk do të thotë që të heqin dorë nga ëndrra juaj. Mos e lini t'ju ikë nga dora ky shans për paqe. Thuani Thaçit se e mbështetni atë.

Demaçi ma priti: - Është e pamundur.

E mbylla telefonin me një ndjenjë pështirosjeje. Kjo bisedë telefonike kishte qenë për mua një nga bisedat më rrëqethëse që kisha pasur ndonjëherë në jetën time!

Edhe Kadare, duke vërejtur se Adem Demaçi këmbëngulte në pavarësinë e plotë të Kosovës, në lirinë e Kosovës, në Republikën e Kosovës, deklaronte, se: Adem Demaçi është kundër krejt botës!

E kush kishte të drejtë më shumë sesa Baca që, nëse nuk vendosej drejtë për fatin e

ardhshëm të Kosovës, të ishte, nëse ishte nevoja, edhe kundër krejt botës!?

7. Si të mos vdiste Bacë Ademi Demaçi i qetë kur, në Kosovën e lirë, pas vitit 1999, për të cilën kishte bërë aq shumë, për të cilën ai vetëm nuk kishte vdekur dhe ringjallur, asnjëherë nuk u shty me bërë për të zënë një pozitë në institucionet e Republikës së Kosovës. Asnjëherë nuk u ankua, asnjëherë nuk i ekspozoi plagët e tija, asnjëherë nuk kërkoi të bëheshim dëshmitarë të atyre plagëve.

Kosova kishte, deri sot, disa presidentë, disa kryetarë të parlamentit, disa kryetar të qeverisë. Po të ishte Baca Adem në njërin nga këto poste: mund të ishte president i mirë, kryetar i parlamenti i mirë, kryetar qeverie i mirë, por nuk do të ishte Adem Demaçi, i cili, me shembullin e tij jetësor, ishte, dhe do të mbetet, personalitet unik dhe i papërsëritshëm në historinë e Kosovës.

8. Si të mos vdiste Bacë Adem Demaçi i qetë kur, ndonëse i kishte vuajtur 28 vite burg, prej të cilave 6 vite në qeli, në vetmi të plotë, në burgjet e pushtuesve të shqiptarëve, ndonëse me kushte kurrfarë, ai la pas vetes të botuara: shtatë romane, një përmbledhje me tregime, një dramë historike dhe një poemë. Ndërsa, të pabotuara në libra të veçanta, la shumë më shumë se këto, të përfshira në qindra analiza, kumtesa, intervista, recensione, fjalime, debate, reagime, deklarate, letra etj.

9. Si të mos vdiste Baca Adem Demaçi i qetë kur, personalitete të shumta, kombëtare dhe ndërkombëtare, e vlerësuan me fjalët më të zgjedhura, në mesin e të cilëve, edhe: Enver Hoxha: Në burgjet e Jugosllavisë vuajnë persekutimet më të egra shkrimtari patriot kosovar, Adem Demaçi dhe qindra të tjerë, të cilët, bashkë me popullin shqiptar, nuk i janë nënshtruar dhe nuk do t'i nënshtrohen kurrë zgjedhës jugosllave. Nermin Vlora: Ndonëse Adem Demaçi ishte 28 vjet në burg, ai e ndiente veten të lirë, megjithëse i lidhur në zinxhir. Shpirti i tij kishte mësuar të dërgonte mendimin e tij njerëzve të lirë, dashamirës të mosdhunës e të paqes.

Imzot Nikë Prelaj: A e keni parë ju Krishtin ndonjëherë? Ja, ky burrë, Adem Demaçi, është Krishti vet! Çka ka bërë Krishti më tepër se ky burrë?

Ibrahim Rugova: Adem Demaçi është letrar i harmonisë shqiptare e njerëzore, humanist i madh. Sot, gati të gjithë, jemi bërë protagonistë të romanit të tij "Gjarpinjtë e gjakut".

Ismaël Kadare: Ju, i dashur Adem, jeni shembull për të gjithë intelektualët shqiptarë e

evropian. Ju jeni shembull i lirisë, për të cilën sot flitet aq shumë, e për të cilën, për fat të keq, bëhet aq pak.

Rexhep Qosja: Adem Demaçin e krahasojmë me liderin jugafrikan Nelson Mendelen. Ky krahasim nuk më pëlqen, sepse është i padrejtë për Adem Demaçin.

Kadri Veseli: Bacës Adem Demaçi çmimi më lartë Hero i Kosovës iu dha, formalisht, në vitin 2010, por, ky titull i takoi që nga dita e parë e arrestimit të tij, më 19 nëntor 1958. Ai, që nga kjo ditë, vijon të jetë Hero i Kosovës. I tillë do të jetë deri sa të ekzistojë Kosova!

Medlin Olbrajt: Adem Demaçi ishte një nationalist i vjetër kosovar. Demaçi më tha - ne i çmojmë përpjekjet tuaja, por nuk duam të nxitohejmi. Ne nuk do të heqim kurrë dorë nga ëndrra jonë për të qenë të lirë!

Riçard Holbruk: E di mirë që Adem Demaçi është përfaqësues i UÇK-së në Prishtinë, por as unë, as ambasadori Hill nuk mund të merremi vesh me të për asgjë. Jeni të njoftuar se sa kam provuar të bëjë punë me të, por me Demaçin, thënë troç, ne nuk mund të merremi vesh!

Kofi Anan: Shqiptarët duhet të jenë krenarë me një njeri, siç është Adem Demaçi.

10. Si të mos vdiste Bacë Adem Demaçi i qetë kur, shumë institucione ndërkombëtare dhe kombëtare, e nderuan duke i ndarë: Çmime, Dekorata, Shpërblime dhe Mirënjohje të panumërta, në mesin e të cilave, edhe:

- Çmimi "SAHAROV" nga Parlamenti Evropian;

- Mirënjohje "DIPLOMË NDERI" nga Asociacioni Ndërkombëtar i Edukatorëve për Paqe Botërore;

- Çmimi "LIZEL DHE LIO AITINBERG" nga Universiteti i Oslo;

- Dekorata "NDERI I KOMBIT" nga Presidenti i Shqipërisë;

- Dekorata "HERO I KOSOVËS" nga Presidenti i Kosovës;

- Titulli "DOKTOR HONORIS CAUSA" nga Universiteti i Prishtinës;

- Titulli "DOKTOR HONORIS CAUSA" nga Universiteti i Tetovës;

- Emërtimi i një sheshi, në Prishtinë, "SHESHI ADEM DEMAÇI" nga komuna e Prishtinës

- Dekorata "QYTETAR NDERI I TIRANËS" nga Bashkia e Tiranës.

11. Si të mos vdiste Bacë Adem Demaçi i qetë, kur, në ditë të fundit të jetës, atëherë kur po e rëndonte sëmundja, kur në disa çaste edhe mund t'i ngatërroheshin mendimet, kur edhe mund të mos e njihje ndonjë mik e bashkëveprimtarë, kur edhe nuk mund të shqiptonte qartë ndonjë fjalë, megjithatë, dy fjalë i përsëriste rregullisht, i shqiptonte mirë, qartë dhe me zë të lartë: KOMBI dhe ATDHEU!

Mijëra persona protestojnë kundër Qeverisë së Moldavisë

Kishiniev, 26 gusht - Mijëra persona janë mbledhur në kryeqytetin moldav, Kishiniev, për të protestuar kundër Qeverisë së udhëhequr nga Partia Demokratike. Protesta e së dielës është në serinë e disa protestave të

organizuara kundër Qeverisë, që janë mbështetur nga diaspora rumune dhe moldave. Protestuesit janë të zemëruar me politikën e Qeverisë që udhëhiqet nga Partia Demokratike, në krye të së cilës është miliarder

kundërthënës, Vladimir Plahotniuc. Duke valëvitur flamurin e Moldavisë dhe të Bashkimit Evropian, protestuesit kanë brohoritur slogane të ndryshme si "Poshtë mafia" dhe "Dërgojeni në burg Plahotniucun".



Maqedonia përgatitet për referendum

SHKUP, 26 GUSHT - Fushata për referendum për Marrëveshjen për emrin me Greqinë, të cilën do ta udhëheqë Parlamenti i Maqedonisë, do të kushtojë 1 milion e 300 mijë euro. Por, ende nuk është bërë e ditur se cilat aktivitete do të mbulohen me këto mjete. Në referendum qytetarët e Maqedonisë duhet të deklarohen se janë për ose kundër anëtarësimit të Maqedonisë në NATO dhe BE me pranimin e Marrëveshjes mes Maqedonisë dhe Greqisë. Partitë politike kanë afat deri sot (e hënë) që të deklarohen se a do të përfshihen në fushatën për referendumin, i cili është caktuar të mbahet më 30 shtator.

Njohësit e çështjeve politike për "Radion Evropa e Lirë" vlerësojnë se pavarësisht se referendumi ka karakter konsultativ, kalimi i pragut të daljes në referendum, përkatësisht dalja mbi 50 të trupit elektoral, legjitimon marrëveshjen e njohur si Marrëveshja e Prespës mes Maqedonisë dhe Greqisë. "Nëse referendumi del i suksesshëm, përkatësisht do të ketë një jehonë mbi 51 për qind nga trupi elektoral dhe pjesa më e madhe do të votojë për, kjo do të paraqiste një legjitimim të marrëveshjes Maqedoni-Greqi dhe



Në referendum qytetarët e Maqedonisë duhet të deklarohen se janë për ose kundër anëtarësimit të Maqedonisë në NATO dhe BE me pranimin e Marrëveshjes mes Maqedonisë dhe Greqisë. Partitë politike kanë afat deri sot (e hënë) që të deklarohen se a do të përfshihen në fushatën për referendumin, i cili është caktuar të mbahet më 30 shtator

në një farë mënyre detyrim për opozitën maqedonase, e cila, edhe pse është shprehur kundër saj, që t'i përkrahë ndryshimet kushtetuese, në funksion të zbatimit të marrëveshjes në fjalë", thotë Xhelal Neziri nga Qendra për Gazetari Hulumtuese SCOOP. Sipas Nezirit, do të jetë

shumë e vështirë të mobilizohen që të dalin në referendum qytetarët të cilët janë të pavendosur ose anëtarësia e VMRO-DPMNESë, nëse kjo parti do të vendosë ta bojkotojë referendumin. "Do të jetë shumë vështirë ata të cilët janë të papërcaktuar sepse të njëjtit nuk janë dhe aq të intere-

suar për atë që është duke rrjedhur si proces politik këtu në Maqedoni. Bëhet fjalë për njerëz që nuk u intereson politika dhe rrjedhimisht nuk u intereson as referendumi. Aty ku duhet bazuar partitë politike janë votuesit e tyre më besnikë, që ata të mund të motivohen që të dalin dhe të

votojnë në referendum", thotë Neziri.

Përderisa analisti politik maqedonas Mitko Gaxhovski vlerëson se partitë në pushtet, të cilat janë deklaruar pro referendumit, duhet të fokusojnë gjithë energjinë për t'ua shpjeguar qytetarëve rëndësinë e marrëveshjes Maqedoni-Greqi dhe perspektivat të cilat i hapen vendit me këtë marrëveshje. Sipas Gaxhovskit, me rëndësi të veçantë është që qytetarëve, përmes kontakteve të drejtpërdrejta, t'u shpjegohet se me marrëveshjen në fjalë në asnjë mënyrë nuk preket identiteti maqedonas. "Duhet të sqarohet mirë çdo detaj i marrëveshjes Maqedoni - Greqi përmes së cilës hapen perspektivat integruese për Maqedoninë si shtet, në mënyrë që, grupe të caktuara apo individë të ndryshëm, të mos merren me spekulime dhe t'i ç'orientojnë qytetarët, duke nxitur dyshime për çështje të ndjeshme, siç është identiteti maqedonas dhe duke i orientuar qytetarët ta bojkotojnë referendumin", tha ai. "Personalisht vlerësoj se pakvoja që zgjidh mosmarrëveshjet mes dy vendeve fqinje, Maqedonisë dhe Greqisë, në planin afatgjatë do të sjellë më shumë efekte pozitive", thotë njohësi i çështjeve politike, Mitko Gaxhovski.

Merkeli në Afrikë do të diskutojë për migrimin dhe ekonominë

Berlin, 26 gusht - Kancelarja gjermane Angela Merkel planifikon ta ngrehë çështjen e migrimit të paligjshëm dhe forcimit të marrëdhënieve ekonomike me Senegalin, Ganën dhe Nigerinë, gjatë turneut në Afrikën Perëndimore, që do ta zhvillojë këtë javë. "Afrika ka shumë konflikte dhe disa njerëz po largohen nga kushte shumë të vështira. Por, e dimë se, në anën tjetër, shtetet afrikane mund të

jenë mundësi e mirë për marrëdhënie tregtare. Shtetet e tjera janë shumë aktive në këto vende", tha Merkel në një video të publikuar të dielën, raporton DPA. Senegali, Gana dhe Nigeria, sipas kancelares Merkel, përballen me pengesa të mëdha dhe kanë rol të rëndësishëm në gjetjen e zgjidhjeve për konfliktet në rajon. "Ne duhet t'i mbështesim këto shtete, veçanërisht kur bëhet fjalë për

perspektivat ekonomike", tha Merkel. "Është e rëndësishme që kushtet e investimeve të jenë të besueshme, në mënyrë që përfaqësuesit e industrisë gjermane t'i kapin shanset e tyre që të futen në tregun afrikane", tha Merkel.

Kancelarja Merkel do ta nisë turneun tregtar në Afrikën Perëndimore të mërkurën. Në këtë udhëtim ajo do të shoqërohet nga një delegacion i zyrtarëve ekonomikë.



TEHERAN, 26 GUSHT - Ministri i Mbrojtjes së Iranit, Amir Hatami, ka aritur në Siri, në një vizitë dyditore, që ka për qëllim thellimin e

Ministri iranian i Mbrojtjes viziton Sirinë

bashkëpunimit dypalësh, raportojnë mediet iraniane. "Ne shpresojmë të kemi rol produktiv në rindërtimin e Sirisë", citohet të ketë thënë Hatami, pasi ka aritur në Damask. Irani, së bashku me Rusinë, mbështet presidentin sirian Bashar al-Assad në konfliktin shtatëvjeçar sirian, ku janë vrarë

qindra-mijë persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur që prej marsit të vitit 2011. Agjencia e lajmeve iraniane "Tasnim" ka raportuar se Hatami parashihet të takohet me zyrtarët e lartë ushtarakë dhe politikë sirianë, me të cilët do të bisedojë për zhvillimet e fundit në rajon, përpjekjet e

përbashkëta kundër terrorizmit dhe mënyrat se si të thellohet bashkëpunimi ushtarak në mes të Teheranit dhe Damaskut. Ministri iranian është paraparë të takohet edhe me presidentin sirian Assad, ka raportuar agjencia e lajmeve "Irna". Vizita në Siri e ministrit Hatami

vjen në kohën kur konflikti ushtarak në Siri është në favorin e Assadit, teksa forcat rebelë janë zhvendosur në shumë pjesë të vendit. Forcat pro-qeveritare siriane janë duke u përgatitur të nisin një ofensivë në provincën Idlib, që është bastioni më i madh i rebelëve.

Në fsh. Priften në malësinë e Grudës, te varri i atdhetarit të madh e të lavdishëm GJERGJ KALAJ
 Në praninë e bashkëshortes së shqiptarit të madh Gjergj Kalaj, atdhetares të nderuares Gjyste Kalaj!
 Në prani të vëllaut Gjovalinit dhe të ,shokëve e miqve të Gjergjit nga vendlindja e Tij e nga Tuzi, nga Shqipëria e nga Kosova, dhe në mënyrë të veçante nga Amerika!

GJERGJ KALAJ, SHQIPERINË E DESHI ME ZEMËR E ME SHPIRT



Ismet SYLEJMANI

Gjergj Kalaj, i lindur më 26 Nëntor 1948 dhe i ndarë nga jeta më 11 mars 2016, me veprimtarinë e madhe që zhvilloi, dëshmoi katërcipërisht se ishte një nga lindjet e mëdha të popullit shqiptar, por kur u nda nga kjo jetë, ishte edhe një nga humbjet e mëdha të popullit dhe të çështjes shqiptare!
 Gjergj kujtdo që ia kanë vënë këtë emër, ia kanë vënë nga dashuria dhe respekti i madh për Gjergj Kastriotin Skënderbeun, ashtu sikur kujtdo që ia kanë vënë emrin Enver ia kanë vënë nga dashuria dhe respekti i madh për Enver Hoxhën!
 Gjergj Kalaj emrin e tij të madh e të lavdishëm, e mbushi edhe më shumë me lavdi e krenari nga rruga enveriane që e ndoqi, sepse çështjen e Atdheut dhe të kombit shqiptar, e deshi me zemër e me shpirt, për përparimin, pavarësinë dhe sovranitetin e tij, një jetë të tërë punoi pa u ndalur dhe nuk kurseu asgjë!
 Për tu përlulur para varrit të Gjergj Kalajt te vendprehja e tij, nga Kosova ishim së bashku me shokun e mikun tim të nderuar Mehmet Prishtina, stërnipin e Hasan Prishtinës!
 Nderimi për Gjergjin, këtë emër e burrë të madh të Atdheut e të kombit tonë, i cili në tërë jetën e tij, asnjëherë kur nuk e ndali hapin, punën dhe aktivitetin e tij në shërbim të çështjes së madhe shqiptare, e cila duke mos u zgjidhur drejtë, na bëri të gjithë ushtarë besnik të luftës për mbrojtjen e

Shqipërisë dhe çlirimin e Kosovës, ishte detyrim i padiskutueshëm karshi të bëmave të tij të mëdha!
 Gjergj Kalaj, ky shqiptar i lavdishëm, që pushonte me eshtrat e tij të arta në token e Atdheut të tijë aty në Priften të Malsisë, ku ne sot i vendosëm lule pranë varrit të tij, historia e jetës së tij, dëshmon se ishte madhështor, konsekuent e besnik, largëpamës e triumfator!
 Shokët që kanë jetuar e bashkëvepruar me të në SHBA dhe edhe ata në Shqipëri e nga Kosova, e njohin si shqiptar e atdhetar të vendosur e të çelikt, që zbatonte me shqiptarizëm të pashembullt, direktivat e kryegjeneralit të popullit shqiptar, të madhit dhe të pavdekshmit, udhëheqësit lavdimadh të Shqipërisë e të kombit shqiptar Enver Hoxha!
 Gjergj Kalaj, ishte njëri ndër themeluesit e klubit kombëtar "Jusuf Gërvalla", klub që u bë i famshëm dhe i dëgjuar jo vetëm në Amerikën e madhe, por në gjithë globin, në mbrojtjen dhe propagandimin e çështjes shqiptare!
 Gjergji Kalaj, ky personalitet heroik i kombit, të cilin e përkujtuam dhe e nderuam në vendlindjen e tij, ishte më meritori për mbarëvajtjen në SHBA të aktiviteteve shqiptare, të cilat ishin ngjarje të pashlyera në mbrojtje të interesave madhore e vertebrale të kombit tonë!
 Gjergji ky pasardhes i madh i Dede Gjo Lulit, Oso Kukës dhe Norës së Hotit e i shumë figurave të mëdha e heroike të shqiptareve të panënshtuar të këtyre anëve, nuk u dekurajua para asgjëje, nuk u thye e nuk e zmbropsi asnjë veshitësi për të marshuar në rugen e madhe e

madhështore të ushtarit e drejtuesit konsekuent në shërbim të Atdheut e kauzës së të parëve për të ecur me kokën lartë dhe për të mos iu dorezuar askujt përpos zotit dhe Atdheut!
 Të ndrosh jetë në Amerikë, dhe të varrosesh në vendlindje e të pushosh përgjithmonë në tokën e Atdheut tënd, kjo është vlerë heronjëshe dhe titanëshe, i tillë dëshmonin shokët se ka qenë Gjergji i panënshtuar!
 Por padyshim se kështu bëjnë figu-

rat e të mëdhenjëve të kombit, ata që dinin çfarë duhej bërë dhe ku duhej shkuar, ata që kanë zbatuar projektet e së ardhmës së bashkuar e të ndritur të vendit të të parëve të tyre!
 Vellau yne Gjergji Kalaj, që na shikonte nga qielli e nga toka, por që na dëgjonte edhe përmes bashkëshortes së tij të jetës, Gjyestes, bashkëudhetarës së tij në rrugën në shërbim të Atdheut, kësaj patriotije të madhe të kombit tonë, por edhe përmes shokëve e miqve që i kishte të shumtë aty afër varrit të tij, te cilët kishin ardhur nga SHBA, Shqipëria dhe Kosova, e që i përulëshin me respektin më të madh!
 Kur Gjergji u nda nga jeta, ne shqiptarët nga Kosova që nuk e kishim njohur nga afër, u hidhëruam shumë nga humbja e tij dhe e përkujtuam në gazetën e famshme shqiptare në Kosovë në të përditshmen "Epoka e Re" të botuesit e gazetarit legjendar të popullit shqiptar, shokut e mikut tim Muhamet Mavraj!
 Për veprimtarinë e madh të Atdheut e të Shqipërisë e të çështjes shqiptare, për shokun e vëllaun tonë Gjergj Kalaj, nderimin që e bëmë për të, e bëmë ngase shoku, bashkëveprimtari e mikut tui madh, atdhetari e shoku ynë Qazim Doda, ishte në pikllim të madh e në vaj nga humbja e parakohëshme Gjergjit!
 E shprehem para popullit dhemb-

jen për Gjergjin, sepse ishte udhëheqësi shqiptar, ndaj i perulemi përgjithmonë jo vetëm këtu ku i pushojnë gjymtyrët e trupit të tij e në veçanti zemra e tij gjigante, që kanë përballuar me heroizëm lodhjen e madhe nga aktiviteti dhe angazhimi enorm në rrugën e lavdisë kombëtare!
 Në Tuz u bë përlurimi i librit për Gjergjin, u dëshmuua se fillimi i madh i nderimit për Të përgjithmonë nisi rrugën e pandalshme!

I dashur dhe shume i nderuar Gjergj Kalaj!

Shoket tuaj nga SHBA e nga pjesët tjera të botës, jo vetëm nuk do të harrojmë kurrë, por do të përkujtojmë e do të nderojmë me pietet të madh e me betim, pusho i qetë vëlla Gjergj, rrugën tuaj në shërbim të popullit e të Atdheut, të nderimit të aleateve tanë te medhenj si SHBA, Anglia e Gjermania, por edhe të tjerë aleat nuk do ta braktisim kurrë!
 Ne shokët tuaj por edhe shqiptarët e ardhshmëm do të ju mbajmë në flamurin e madh të mirënjohjes në shekuj e mijëvjeçarë!
 Mbi gjithëcka është Atdheu dhe kombi ynë!

Nderim e lavdi përgjithmonë, për Ty e veprën tënde shoku e vëllaun ynë Gjergj Kalaj!
 Lavdi!

Prishtinë, 26 gusht 2018

EPOKA E RE

Vala e-Commerce
BLEJ MBUSHJE ONLINE

Diell, 13 Mars 2018

FILLIMI | POLITIKË | EKONOMI | INTERVISTA | OPINIONE | KOMUNA | FEJTONE | BOTE | KULTURE | SPORT | SPEKTER | SHPALLJE
Kur: Kosovë bëhet në një krizë të thellë

Organizator i madh shqiptar në SHBA

Nderroi jetë Gjergj Kalaj

26 Nëntor 1948 - 11 Mars 2016

13.03.2016 | 11:47

Veprimtari i çështjes kombëtare, Ismet Sylejmani, nderon me rastin e ndarjes nga jeta të organizatorit e veprimtarit të madh shqiptar në SHBA, Gjergj Kalaj.

Lavdi e përlurime kontributit të madh në shërbim të kombit, atdheut e popullit shqiptar, të patriotit të shquar Gjergj Kalaj

Me nderim e përlurje
Ismet Sylejmani.

Prishtinë, 13 mars 2016

Mbi si ruan | Eto të reaktuar

11:23 | KDI-ja: Vizat detyrojnë luftimin e korrupsionit

11:10 | Kur: Kosova bëhet në një krizë të thellë

10:46 | Opozita t'u kthehet njetëve demokratike

11:47 | Organizator i madh shqiptar në SHBA

23:44 | Jajjaga takoi mbretin e Jordanisë

23:28 | S'ka datë për vizat

22:18 | Pacoll nis fushatën për fuqizimin e AKR-së

PARAPARATHËNIE

Berat ARMAGEDONI

I dashur lexues,

Tekstin e mëposhtëm, prej ku fillojnë shkronjat kursive, mund ta kesh lexuar para tetë muajsh në ndonjë media fizike ose elektronike. Por, po pate kohë, lexoje edhe një herë, se kam bërë disa plotësime në të, shumë të nevojshme tash që kanë kaluar 250 ditë prej daljes së numrit të parë të revistës "Akademia".

Shtëpia ime botuese "Armagedoni", të cilën e udhëheq unë, Berat Armagedoni, idenë për botimin e kësaj reviste, po me këtë titull, "Akademia", e kishte para dhjetë vjetësh. Atë e kisha unë. Dhe, në asnjë vit, prej ardhjes së idesë e deri në realizimin e saj, nuk kam pasur drojë se emrin e saj do ta marrë dikush sepse, atyre që u thosha për botimin e saj, sa frikësoheshin e rrëqetheshin prej emrit serioz të saj, po aq nuk shprehnin gatishmëri për të më përkrahur financiarisht për botimin e saj, edhe pse parave dhe pasurisë që kishin dhe që kanë, nuk ua dinin, ashtu siç nuk ua dinë as sot, skajin. Të njëjtit njerëz shpenzojnë për blerje dhe për mirëmbajtje të veturave luksoze, për rroba të shtrenjta, për ushqime dhe për pije, po ashtu, të shtrenjta. Për kulturë dhe gjuhë e media, asnjë metelik, këta "armiqtë e tyre", këta "armiqtë tanë", s'e japin se nuk e japin. Për sëmundje, edhe truallin e luajnë vendit. I natyrshëm ky reagim sepse shëndeti është, para së gjithash. E ju tash, sigurisht po e pyesni veten për mua, se pse më duhej përkrahja dhe pse u kërkoja atyre përkrahje. Dhe, po ashtu, pse duhej të më përkrahnin. E unë ju them se, po qe se e lexoni tekstin deri në fund, e merrni edhe përgjigjen.

E di se ata miq kujtonin, siç mund të kujtojnë sot edhe më pak sesa që kisha vite më parë, se ky titull i revistës është i ndaluar për përdorim nga të tjerët dhe se është i rezervuar vetëm për dy akademitë shqiptare: për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Botimi i kësaj reviste për kulturë, gjuhë, media, ua kujton atyre tash këmbënguljen tume të atëhershme, diskutimet që kishim për realizimin e saj, për shtypjen fizike dhe, pastaj, për ngarkimin e saj në internet dhe për ofrimin për leximin online, atyre lexuesve që s'i lëshojnë nga duart celularët, aipedët, llaptopët, as atyre që kohë të gjatë nuk e heqin shikimin nga kompjuterët dhe që janë bërë robër të pajisjeve të teknologjisë informative dhe argëtuese, e cila u ndihmon shumë t'i shterin sytë, ta shtojnë agresivitetin në kokë dhe të njëjtin ta shfaqin në shoqëri dhe të shkujdesen për jetën, gjatë gjithë jetës.

Ritheksoj prapë, ata miq, që kishin

dhe kanë shumë para, nuk më ofronin përkrahje financiare për, së paku, botimin e një numri të kësaj reviste. I konsideronin të parëndësishme kulturën, gjuhën, mediat, veçanërisht median dhe mediumin fizik. Thoshin se s'ke pse e bën këtë punë. Madje-madje, s'ke as për kënd ta bësh, se njerëzit sot duan të bëjnë politikë e jo kulturë; se s'ke nevojë të shpenzosh para për letër dhe për të panjohur, kur e gjithë shoqëria e sotme është shoqëri interesi dhe, sipas bindjes së tyre, e sëmurë.

Duke pasur këtë bindje të mbrapshtë për një pjesë të shoqërisë së shëndoshë, më sugjeronin, sa herë që takoheshim e ua përmendja me këmbëngulje botimin e kësaj reviste se, "nëse dëshiron të bësh diçka të mirë, bëje një media online", pa u shkuar mendja atyre se media online nuk është institucion i kulturës, i gjuhës, i medias, i trashëgimisë kulturore të vendit dhe të Kosovës; se nuk është punë e mirë themelimi i saj. S'i shkonte asnjërit mendja se kjo media e shpejtë shlyen kujtesën për punët tona të para dhe të të parëve tanë, shumë shpejt. Po ashtu, s'u shkonte mendja se s'do t'i mbajë kush mend sukseset e tyre, sepse s'do të ketë kush t'ua tregojë, sepse asnjë media online e vonshme me dije artificiale s'do të kujdeset për hershmërinë e tyre. Qe pse.

Meqë punoj në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, në të cilën deponohen libra për çdo ditë me qese dhe me paketa nga njerëz të ndryshëm, nga autorët të vjetër dhe të rinj, u tregoja për gjendjen e sotme të librit dhe të gazetave që futen aty. Aty autorët ose botuesit sjellin ekzemplarët e detyrueshëm të librave fizikë, por jo edhe botuesit gazetave. Për këto të fundit, është një djalë, një punonjës biblioteke që quhet Habib, i cili, për çdo ditë, në dy kioska në Prishtinë, nga ato që i ka më afër bibliotekës, por edhe nëpër redaksi të gazetave, mbledh nga pesë ekzemplarë të "Epokës së re", të "Kohës ditore", të "Zërit", të "Botës sot", të "Kosovës sot" dhe i sjell në bibliotekë për shërbim të studentëve dhe për t'i arkivuar e deponuar të tjerët punonjës ndërkohë në depot e bibliotekës. Sa herë që shkon t'i mbledhë gazetave, Habib pret t'i thotë dikush në dyert e redaksive të gazetave, ose shitësit e tyre në kioska, se shtypit të gazetës ia kemi dhënë dhe vënë drynin. Pret, për çdo ditë, t'i pakësohet puna. Pret t'i pakësohen metrat që bënë këmbë nga njëra redaksi në tjetrën, nga njëra kioskë në tjetrën, në çdo stinë të vitit, në çfarëdo moti. Pret t'i thonë, sepse i kanë thënë kështu ata që i botonin gazetën "Express", "Infopress", "Lajm", pastaj edhe të tjerët që i botonin "Iliria Postin", "Prishtina Timesin", "Tribunën", "Prishtina Insightin", "Nacionalin", "24 orë"

e shumë e shumë të tjera që kanë qenë e që më nuk janë e as nuk lexohen për çdo ditë nga lexuesit brenda Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", e cila ruan dhe mbron - pushtetin e katërt brenda mureve të veta.

I kanë thënë, po kështu si Habibit, edhe një punonjësi tjetër të Bibliotekës, Fadilit, i cili, kohë më moti, bënte të njëjtën punë, mbledhte nëpër kioska gazetën "Rilindja", "Bujku", "Zëri i rinisë" e të tjera. (Këto janë mbyllur sepse s'kanë mundur t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet, sepse shtypi i përditshëm kushton shtrenjtë. Me një fjalë, të hanë të gjallë pak nga pak. Kush ka qenë botues i këtyre e di mirë pse e ka mbyllur). Disa prej këtyre mediave, ato sipër këtyre të fundit, e kanë ndaluar daljen fizike, por e kanë vazhduar atë elektronike. Por, këto media online, fatkeqësisht, nuk i shërbejnë ruajtjes së kujtesës kombëtare. Me pak fjalë, kanë vlerë të përkohshme dhe të vogël. Tregojnë çfarë ka ndodhur sot, por jo çfarë pat ndodhur para pesë ose dhjetë vjetësh. Anë pse kanë një tru të madh e të shpejtë e funksional vetëm kur ka energji elektrike dhe qasje në internet, këtyre pajisjeve mund t'u shlyhet kujtesa shumë shpejt. Të harrojnë gjithçka. Gjithë kulturën tonë. Gjithë gjuhën tonë. Gjithë punën e mediave të mëparshme. Prandaj ky medium, apo kjo "lopë" e mirë që jep qumësht shumë, rrezikon të kaluarën tonë dhe ne rrezikojmë punën tonë nëpërmjet tij, publikimit të teksteve tona në të, për ngjarje të rëndësishme kombëtare, sociale, kulturore, gjuhësore e çfarë jo tjetër. Po kështu, rrezikon të shuhet i gjithë shtypi ditor sepse nuk kujdesen për të lexuesit (që nuk e blejnë gazetën); nuk kujdesen për të menaxherët e kafeterive, të restoranteve e të lokaleve të ndryshme që i ushqejnë dhe i argëtojnë njerëzit me muzikë e nuk e mbajnë një gazetë në tavolinë; nuk kujdesen për të bizneset që prodhimet dhe ofertat e veta nuk i publikojnë edhe në shtypin fizik; nuk kujdeset për të as shteti siç kujdeset për Teatrin Kombëtar të Kosovës dhe për teatrot nëpër qytete të Kosovës, e për Qendrën Kinematografike të Kosovës, për Galerinë Kombëtare të Kosovës, për Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, për Ansamblin e Këngëve dhe Valleve "Shota", për institucionet e tjera të kulturës të Kosovës që ruajnë dhe mbrojnë trashëgiminë e Kosovës e që, asnjëri prej këtyre, nuk i sjellin fitim buxhetit të shtetit por, po secili prej tyre, e varfërojnë, kush më shumë e kush tjetër më pak. Megjithatë, ashtu si janë dhe kështu, me shpenzime të mëdha e me numër të madh të punonjësve, mbahen gjallë nga të hyrat e tjera që sigurohen nëpërmjet institucioneve të tjera. Kësi kujdesi dhe mbështetje financiare shteti duhet të ketë dhe të japë

edhe për median fizike, siç jep Ministria e Kulturës për libra dhe për revista një herë në vit, po qe se dëshiron ta ruajë të kaluarën e vet për brezat e ardhshëm. Dimë që, në vitin tjetër, kur revista "Akademia" mbush dy vjet jetë dhe boton katër numra, po kjo ministri do të na përkrahë edhe neve, pra do ta ndihmojë botimin e revistës me taksat tona që i japim për çdo ditë.

Së këndejmi, kisha dhe kam disa miq të tjerë që, kur bisedojmë për kulturë, gjuhë dhe për media, më thonë se shkruajnë vazhdimisht për kulturë, për gjuhë, për media, për sociologji, për filozofi, për shkencë, për libra të mirë dhe për të këqij, por më ankohen se nuk po kanë ku t'i botojnë opinionet, analizat, vështrimet dhe studimet e gjata. Më ankohen se gazetave e përditshme nuk po ua publikojnë përnjëherësh, se po ua botojnë në katër-pesë vazhdime, kurse se, në mediat online, po bëri e i publikuan, nuk i lexon kush gjithë ato që i shkruajnë e i publikojnë, nga 50 000 - 60 000 karaktere përnjëherësh e më shumë. Madje se, sipas tyre, kur i dërgojnë për botim, të paktat redaksi ua botojnë aq gjatë. Edhe se, disa shkrime që i kanë publikuar në disa media, nuk i kanë gjetur më kur i kanë kërkuar kohë më vonë. (S'i kam gjetur as unë të miat që i kam botuar në disa prej tyre). Vazhdojnë të më arsyetohen se e kanë ruajtur vjegëzën e tyre, por tashmë e kanë të pavlerë dhe të paqasshme në internet. Megjithatë, duhet ta kenë parasysh të dyja palët, autorët dhe botuesit, se ata që duan të lexojnë, që janë dashamirës të shkrimeve sikurse jeni ju, lexojnë edhe kur shkruhet shkurt, edhe kur shkruhet gjatë, pa marrë parasysh a është ai medium fizik apo elektronik.

Dhe, ajo çfarë duhej të bëhej edhe për këta që thonë se dinë të shkruajnë, që thonë se, po patën ku t'i publikojnë shkrimet, shkruajnë me qejf, nisi të bëhet kështu me të tjerë njerëz, me botimin e kësaj reviste për tri fushëveprimtarit të mëdha e të rëndësishme, për të cilën, së pari, mirëkuptim dhe përkrahje i kërkova familjes sime të ngushtë (gruas dhe vajzës), pastaj asaj pak më të gjerë (babait, nënës, motrave dhe vëllait). Thjesht, kërkova nga ta të mos presin hëpërhë para nga unë, të paktën derisa njerëzit përnjëmend ta kthejnë jo vetëm kokën, por gjithë vëmendjen kah kultura, kah gjuha, kah mediat dhe mediumet e shtypura; kah një revistë që, me synimet që ka sot redaksia e "Akademisë", në një të ardhme jo shumë të largët mund të transformohet në një medium më të madh, edhe në një objekt, po ashtu, me hapësirë më të madhe, në të cilin mund të merret dhe të jepet dije tjetër dhe më e rëndësishme dhe më e favorshme sesa këtu, nga njerëz që s'dinë vetëm të

shkruajnë, por edhe nga ata që dinë të flasin bukur, që dinë të flasin edhe bindshëm.

Kur thashë se njerëzit duhet ta kthejnë kokën kah "Akademia", e mendova këtë: që ata duhet ta kërkojnë, ta gjejnë, ta blejnë dhe ta lexojnë këtë revistë. Fuqia e "Akademisë" jeni ju, lexuesit e saj, pastaj janë sponsorët. Të parët e kanë dëshmuar vetën - interesimin e tyre - duke e blerë numrin e parë dhe të dytë të revistës. Të dytët do ta dëshmojnë, bashkërisht me ju, tash e tutje. Megjithatë, s'e kemi bërë këtë revistë për të bërë para më shumë. E kemi bërë për të bërë punë më të vyeshme dhe më të shumta dhe për t'u dhënë përkrahje njerëzve që shkruajnë mirë, shkurt dhe gjatë. Nëse na pyesni "kur do të shpërblehemi edhe ne", ju themi se do të japim honorarë për autorët kurdo që përkrahemi financiarisht nga sponsorët, nga Ministria e Kulturës e ndonjë institucion tjetër ose individ a biznes. Neve na mjaftojnë paratë vetëm për publikimin e saj. Neve na mjafton që njerëzit që shkruajnë bukur shqip dhe që shkruajnë mirë, të kenë një organ shtypi për botimin e shkrimeve të veta dhe ta kenë si të vetin, nën përgjegjësinë tonë: timen dhe të anëtarëve të redaksisë. S'duam asgjë më shumë nga askush. Asgjë.

Kështu që, për ta realizuar idenë për këtë revistë dhe për t'ua hapur derën atyre njerëzve që shkruajnë gjatë dhe që tekstet e veta serioze dëshirojnë t'i botojnë në revista fizike, së pari u bëra ftesë për bashkëpunim pesë anëtarëve të redaksisë së revistës: Salajdin Salihut, Adem Gashit, Haqif Mulliqit, Rovena Vatës dhe Arif Molliqit, ndërkohë edhe Ali Pajazitit, Shpresë Mulliqit dhe Fadili Bajrajt. Pastaj, bashkë me këta, kush më shumë e kush më pak, nisëm bashkëpunimin dhe u bëmë thirrje disa miqve të rinj dhe të vjetër, në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni, edhe një pjesë tjetër që jeton dhe krijon në shtetet perëndimore, që as nuk na kishin harruar e që as nuk i kishim harruar. Pra, u bëmë ftesë për bashkëpunim Rexhep Qosjes, Shefikje Islamajt, Bajram Kosumit, Ibrahim Gashit, Zymer Nezirit, Ardian Kyçykit, Bedri Zyberajt, Hajdin Abazit, Dije Demirrit, Alma Lamçes, Klodian Briçit, Jorida Sotirit, Irena Gjonit, Albanë Mehmetajt, Ragip Sylajt, Eris Rusit, Arlind Farizit, Erenestina Gjergji-Halilit, Sali Bashotës, Isuf Sherifit, Mehrije Dacit, Lulëzim Etemajt, Sadik Krasniqit, Shefqet Dibranit, Bujar Mehollit, Brikena Qamës, Albana Kozelit, Josif Papagjonit, Emin Eminit, Donard Hasanit, Arian Krasniqit, Mentor Hajrizit, Arsim Jonuzit, Muhamet Mavrajt, edhe të ndjerit Ganimet Klaiqit, i cili, sa qe gjallë, ma kishte lënë dorëshkrim punimin e vet të masterit të mbrojtur në

Fakultetin e Filologjisë, në Degën e Gjuhës Shqipe, për "Njoftueshmërinë në titujt e gazetave në Kosovë", një pjesë të të cilit e gjeni në numrin e parë të kësaj reviste.

Për dallim nga këta që mbajtën fjalën, disa njerëz të tjerë, të cilëve u besuam dhe të cilët i patëm zgjedhur për bashkëpunim, na dështuan në orët e fundit, ani pse për dhjetë ditë rresht, në llogarinë time në "Facebook", në kopertinë, ua kujtoja ditët e fundit të daljes së numrit të parë të revistës, duke numër mbrapsht 10, 9, 8, 7, 6, 5, 4, 3, 2, 1 dhe, në ditën 0, kur s'kisha pse t'i prisja më, nxora ballinën e revistës aty ku për dhjetë ditë rresht i nxora këta dhjetë numra, për t'u rënë, po për çdo ditë, "çekan" kokës së tyre e për t'ua kujtuar fjalët që na kishin dhënë. Mbase këta njerëz janë po si ata miqtë e mi që jua përmenda që në fillim të këtij shkrimi, që as nuk donin kulturë më të mirë, as gjuhë më të saktë, as media që na ruajnë kulturën dhe gjuhën, të mirat dhe të këqijat tona që shkruajmë dhe që bëjmë.

Megjithatë, pavarësisht prej mospërkrahjes së tyre, sërish e kanë derën hapur në këtë revistë për publikim të teksteve që kanë vlerë, edhe për diskutim të këtyre vlerave letrare dhe shkencore që janë publikuar në numrin e parë dhe të dytë e tash në të tretin të revistës. E kanë derën hapur të gjithë ata njerëz që dinë të shkruajnë. Po, sepse, po qe se e keni parë ballinën e numrit të parë revistës, aty e keni rezën e derës, te plisi që ka formën e A-së, e që është një skulpturë e Agim Islamajt me temë "Shqiptarët", me të cilën u bëhet ftesë shqiptarëve për shkrime. Ju mjafton vetëm ta ulni atë rezë poshtë, pa pasur nevojë ta fusni çelësin në vrimë, të futeni brenda dhe ta fillojmë bashkëpunimin për kulturë, gjuhë, media dhe, po bashkërisht, ta bëjmë një revistë me vlera edhe më të mëdha e më të shumta sesa kanë tre numrat e saj. Së këndejmi, ju bëj me dije se revistën, edhe po qe se kurrë nuk i jepet përkrahje financiare nga askush, do ta botoj shtëpia botuese "Armagedoni" pa ndihmën e askujt. Por, me ndihmën dhe përvojën e juaj, "Akademinë" mund ta bëjmë shumë më të mirë sesa që është tash dhe të lexueshme nga kushdo dhe nga çdo moshë e njerëzve.

Në këtë rast, ju lutem më falni dhe pak kohë sepse dëshiroj t'i falënderoj, po për bashkëpunim, edhe autorët shqiptarë dhe përkthyesit e shkrimeve të autorëve të huaj, për numrin e dytë dhe të tretë të revistës, si: Mehmet Krajën, Milazim Krasniqin, Valbona Nathanailin, Halil Matoshin, Qemal Muratin, Virion Graçin, Rakela Yzeirin, Sadete Tërnavën, Agim Zogajn, Elida Rustën, Lindita Aliun, Nertila Zanin, Ibrahim Kadriun, Gani Mehmetajn, Isuf Sherifin, Leonora Buçincën, Lulëzim Tafën, Murteza Osdautajn, Albin



Mehmetin, Butrint Berishën, Faruk Tashollin, Izet Abdylin, Naim Fetajn, Hajdin Morinën, Afet Belën, Bujar Salihun, Donart Rexhbogajn, Edona Halitun, Agron Shalën, Ndrëçim Ademajn, Ekrem Kryeziun, Bujar Tafën, Klodian Gjonin, Ragip Gjoshin, Arben Veselajn, Qëndrim Morinën, Muharrem Miftarin, Majlinda Ramën, Entela Tabakun, Resmije Kryeziun, Donika Gashin, Nora Lokajn.

Jam shumë i nderuar dhe jashtëzakonisht u shpreh falënderim dhe respekt përkthyesve: Fadil Bajrajt, Rexhep Malokut, Besim Kokollarit, Rrona Jakajt, Feride Berishës, Luan Ramës, Ali Pajazitit, Roland Çipës, Fatijona Bajrajt, Vlora Konushevcit, Fahredin Shehut, Shpresë Mulliqit, Alfred Bekës, Ardian Kçyçkut, Leonora Buçincës, Nikollë Berishajt, Renato Kalemit, Tahir Dalipit, Brikena Qamës, Armela Hysit, Drita Lazrit, Kujtim Morinës, Llambro Rucit, Azem Qazimit, Aida Brahos, Ibrahim Kelmendit, Isuf Sherifit, Verjon Fashos, Miranda Içit, të cilët përkthyen, enkas për revistën, shkrime të shkrimtarëve që tashmë i njeh dhe i nderon e gjithë bota. Të gjithë këta, autorët dhe përkthyesit, i falënderoj bashkërisht dhe veç e veç sepse nuk e di si do të bëhej revista pa këta emra të respektuar, të cilët e mbajtën fjalën që na kishin dhënë: na dërguan, me kohë, shkrimet për botim në revistë, për numrin e parë. Janë edhe disa autorë artistë të tjerë që, me vepra bërë nga duart e tyre, ia shtuan vlerën dhe bukurinë revistës, si: Agim Islamaj, Agim Sulaj, Majlinda Kelmendi, Albana Ejupi, Zenun Sherifi. Tashmë, për fund, më vjen t'ju them sikurse ju kam thënë në dhjetor të vitit të kaluar: Gjejini, blijeni dhe lexojeni "Akademinë". Dhe, t'ju them që, deri në numrin e katërt, mirëmbetsh!

Nr. 3

AKADEMIA

revistë për kulturë, gjuhë, media

AKADEMIA
revistë për kulturë, gjuhë, media

Mario Vargas Llosa
Jean Baudrillard
Rüdiger Saepke
Marc DeLancey
Paul Simpson
Amiri Baraka
Bob Kaufman
Charles Bukowski
Allen Ginsberg
Gary Snyder
Ilhan Berk
Lawrence Ferlinghetti
Pol Eluard
Roger McGough
Charles Baudelaire
Hans Belting
Kajiro Suga
Rajut Nari Gantika
Bakir Sijez Ertegan
Orhan Veli Kanik
Abani Neqip Feriz Kizakirek
Cemal Sireya
Ozalimir Avol
Nazim Hikmet
Atatol Behramoglu
Ragip Sëljaj
Hasif Mulliqi
Qemal Murati
Agron Shala
Ndrëçim Ademaj
Ekrem Kryeziu
Artif Molliqi
Bedri Ziberaj
Salajdin Salihu
Bujar Tafa
Sadik Krasniqi
Klodian Gjonin
Ragip Gjoshi
Butrint Berisha
Arben Veselaj
Lulëzim Etemaj
Albin Mehmeti
Shefqet Dibrani
Hajdin Morina
Bujar Meholli
Qëndrim Morina
Murteza Osdautaj
Muharrem Miftari
Izet Abdylh

Hannah Arendt
Lindita Aliu Tahiri
Entela Tabaku Sörman
Majlinda Nana Rama
Irena Gjoni
Dije Demiri-Frangu

Vesna Parun
Shpresë Mulliqi
Resmije Kryeziu
Donika Gashi
Rovena Vata
Nora Lokaj

(Përkthyes për këtë numër: Fadil Bajraj,
Rexhep Maloku, Rrona Jakaj, Shpresë Mulliqi,
Verjon Fashos, Feride Berisha, Luan Rama, Ali Pajazitit,
Roland Çipë, Fatijona Bajraj, Vlora Konushevcit,
Valbona Nathanailin)

'Akademia' futet në shtyp

Prishtinë, 26 gusht - Numri i tretë i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia", botuar nga shtëpia botuese "Armagedoni", të shtunën është dorëzuar në shtyp dhe pritet të dalë në treg të premtën. Në këtë numër të revistës janë botuar intervista, ese, shkrime publicistike, studime për letërsinë, gjuhën dhe mediat; pastaj shkrime kritike, recensione, poezi, prozë. Revista ka 606 faqe të madhësisë B5. Tridhjetë për qind të parave nga shitja e saj, sipas kryeredaktorit të revistës, Berat Armagedonit, do të jepen për vajzat dhe gratë e prekur nga kanceri i gjirit. Kështu ka shkruar ai të shtunën në një njoftim bërë në "Facebook" për publikimin e revistës, në të cilin ka ngarkuar edhe fotografinë e kopertinës së numrit të tretë të revistës.

BUKURI QË VRET

Deri para një ore koka më vlonte sikurse gjella në tenxhere. Me anëtarët e revistës kemi kryer revistën, brendësinë dhe përmbajtjen e saj, qysh dje. Për sot na kishte mbetur dukja e saj e jashtme, ajo që në shikim të parë të tërheqë si për hunde,

që ose dashurohesh, ose ndien dhembje e keqardhje për të, ose e urren për shkak se ka një histori ankthi përbrenda vetes që shqetëson përditë.

Kjo "bukuri që vret", në anën e djathtë të revistës, ka një pamje të një skulpture prej guri punuar nga skulptori Agim Islamaj. E ka punuar para disa vjetësh me përkushtim: për gratë që janë prekur nga kanceri i gjirit, për ato që kanë ndërruar jetë nga kjo sëmundje dhe për të tjerat që çohen dhe bien me frikë se mos u shpërndahet edhe më tutje e keqja në trupin e tyre. Përkushtim dhe nderim tjetër, nga gratë për gratë dhe nga burrat për gratë, nuk ditëm të bëjmë sesa ka bërë Islamaj në vepër guri me çekan, daltë dhe limë dhe sesa kanë bërë të gjithë këta autorë dhe këto autore me shkrime të ndryshme. Por, mund të bëjmë më shumë për gratë materialisht nëse keni gatishmëri dhe atë ndjesi sikurse e keni kur vizitoni të sëmurët në spital: mund ta shesim revistën dhe 30 për qind nga shitja e saj, aq sa na marrin libraritë për shitje të një ekzemplari, t'i japim për gratë që vuajnë nga kanceri i gjirit. A jeni të gatshëm? Në rregull,

pra. Revistën, nga e premtja e ardhshme, të tre numrat, i gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re". Nëse shprehin gatishmëri edhe mediat e tjera për shitje të saj, jua dërgojmë aq ekzemplarë sa kërkojnë. Paratë nga shitja e numrave të revistës le t'ua japin vetë atyre vajzave dhe grave që vuajnë nga kanceri i gjirit - që njohin ose që ua propozon dikush. T'ju them dhe këtë gjë.

Me të parin njeri që po e diskutoja dukjen e revistës ishte gruaja ime. Më tha: "E bukur duket, po ka në të 'bukuri që vret' dhe që, ata që e shohin, sidomos vajzat dhe gratë, mund të diskutojnë me vetveten po qe se duhet ta pëlqejnë dhe shpërndajnë". E pyeta: "A e di pse është bërë kjo skulpturë?" Më tha: "Për ta paraqitur hijeshinë e një pjese të trupit të gruas". I thashë, ndër të tjera: "Edhe për t'i nderuar dhe kujtuar ato gra që vuajnë nga kanceri i gjirit, për shërimin e të cilave, për mbledhje të fondeve për shërim të tyre, do të jepja leje të zhvishesh edhe ty tash që je në ditët e fundit të lindjes së një vajze tjetër". Faleminderit çdonjërit autor që ka kontribuar për këtë revistë!



		Autor: GAZMEND MORINA	BURG KU MBAHESHIN DËNIMET E RËNDA DHE TË GJATA (shq.)	HIT NGA VESA LUMA	AKTORJA ANGLEZE HALL (shqip.)	IRNOSE (bised.)	SHTET NË AMERIKËN JUGORE	ADRIAN KRASNIQI	PJESË E DHOMËS	I NJËZËSHËM	RADIUM, TON	MËSYMJE	TASH
	VIZATIM QESHARAK (sh.shq.)												
	MUZIKA E SHTHURUR												
	KORJE							ATDHE ISH FUTBOLLISTI FRANCEZ CLAUDE					
	NËNË (turq.)					BESIM; BESË (mysl.) JURIST QË JEP NDIHMË LIGJORE					KUDRET ISAI USHQIM QË SHTROHET E HAHE GJATË PJES		
	QYTET I SHENJTË I MYSLIMANËVE						PËRKULJE NË NJËRËN ANË KATËR (romak)					FUTBOLLISTI FRANCEZ (ROMA)	GADISHULL NË GREQI
	QË SHFAQET SI MBETURINË E TRASHË- GUAR NGA TIPARET E PARAARDH- ËSVE TË LASHTË								POLITIKANI ILIR SHKRIMTARJA KAMBERI				
	BASHKËTING.			TRAJNERI BRAZILIAN LUIZ FELIPE	FUTBOLLISTI ANGLEZ MAJKËLL ABEDIN REXHA					PERËNDI FOLTRET			
EPOKA E RE	KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO	LLOJ LËNDE PLASËSE	FJALË ME TË CILËN QUHET NJË NJERI	KRYEQYTETI I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN	ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE (shk. orgj.)	SHKENCËTARI NJUTON DY BASHKË- TINGËLLORE		FRIKË E MADHE GOTË PREJ METALI					
	ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË												GRYKA E VULLKANIT ISH FUTBOLLISTI TARE
	MJET TRANSPORTI PA MOTOR, QË TËRHIQET NGA NJË AUTOMJET						KRYEQYTETI I ESTONISË NJË PREJ FIGURAVE STILISTIKE						ZANORE SHALQI
	E MALLKOVA					GREATER LONDON AUTHORITY MODELJA SHQIPTARE ÇUNMULAJ		LUMË NË SHQIPËRI IPSVICH					I GJYMTON
	AKTORJA E NJOHUR REID				HOVI, VRULLI SMALTI			UÇK (ang. orgj.)	GRIMCA MOLEKULARE ZANORE				
	ARIAN MALIQI		FUTBOLLISTI MOTA (INTER)	DRAMË E FRANCEZ ANTON SANTORIT INDIA, ZAMBIA			TRUP GJEOMETRIK FUSHËBETEJA				TORACIC OUTLET SYNDROME HEROI KRASNIQI (shq.)		
	PROFITI ZEJTAR (shq.)					I JAP DIKUJT NJË GJË PA I KËRKUAR SHPËRBLIM I TURPËROJ			EMËR I VJETËR PËR LUBJANËN KOMPOZITORI DHOMI				
	→						KOHË E PUNËS FSHATI I KOMANDANT ISMET JASHARI - KUMANOVA			QË ËSHTË VETËM NJË; QË S'KA TJETËR TË NGJASHËM ME TË SHTËT (FR.)			
	AUSTRIA	ZANORE PARIA E SHOQËRISË (sh.shq.)		VIJË E PËRKULUR SI LAK "M" pas dy "R"				AMERICAN ECONOMIC JOURNAL RRUZULLI I TOKËS				"KALJARI" FALJA FETARE QË BËJNË DISA HERË NË DITË MYSLIMANËT	
	ZEZAK, IZI					LLOJ MAJMUNI "URUGUAI"							BASHKËTING. MAL NË SHQIPËRI
	GAZ PËR DEZINFEKTI- MIN E UJIT				NEVOJË E THEKSUAR QË KEMI PËR TË NGRËNË FUTBOLLISTI TIERI		SHKRONJË GREKE BUJK				PËREMËR VETOR ISMET KADRIU		
	BRUS ..		KËNGËTARJA IKONOMI "... ISHIN KATËR"					ZANORE VËLLAI I MADH	MJET PËR DREJTMIN E VETURËS SHOUMENI KRASTA				
	INTENSITET, TANTAL			SHKRONJA XIX ANTON PASHKU		KANATË DËRRASE PËR TË MBYLLUR NJË DYQAN (shq.) ZANORE				POSEDOJ DIÇKA AKTORJA SUEDEZE MARGRET			RIFAT AVDIU
	MENDJEHOLLI					E VRULLSHME, E RRËMB- YESHME BASHKËTING.							SHTRËNGIM QË I BËHET DIKUJT PËR DIÇKA (bised.) BASHKËTING.
EPOKA E RE	DOKUMENT I VJETËR MBI PRONËSINË E TOKËS					BITUMI		ISH POLITIKANIA INDIANE GANDI					

ZGJIDHJA E FJALËKRITË: KARIKATURAT, AMERIKANATA, ZABEL, VATAN, ANE, IMANI, MEKA, ANIM, ATAVIK, META, T, OVEN, ZOT, ISAK, LEBETI, ADEKIM, KRATERI, IK, RIMORKIO, TALINI, A, E NËMA, GLA, SEMANI, TARA, ELANI, ATOMI, AM, EMIRA, KON, TOS, FITIMI, I FAL, EMONA, ARTIZANI, ORAR, UNIK, A, A, LAKORE, AEU, KA, NEGRI, ORANGUTAN, T, KLOP, URI, ALFA, ATO, LI, MARIZA, O, TIMON, ITA, N, TARABA, KAM, NATAR, RAPIDE, ZOR, TAPI, SERA, INDIRA.

E rrallë

Ishulli pa polic

Ishulli i Santa Kruzit, në arkipelagun San Bernardo të Kolumbisë, është një nga vendet më të populluara në botë. Shtëpitë plot ngjyra janë ndërtuar prej shumë kohësh e janë trashëguar brenda familjeve dhe në ishull nuk ka asnjë banor që nuk ka lindur aty. Juve Nal, një nga banorët që ka jetuar gjithë jetën aty, thotë se janë rreth 900 banorë. "Këtu nuk ka krime", thotë ai. "Nuk kemi polici, nuk kemi pasur ndonjëherë dhe nuk kemi nevojë për të", ka treguar ai.



FOTO E DITES



Një pamje nga qielli tregon njerëzit në një plazh në brigjet e liqenit Silbersee në Haltern të Gjermanisë. /Reuters/

E jashtëzakonshme

Mban 5 200 persona, del në det "mbretëresha" gjermane

Një anije si "përbindësh" ka dalë për herë të parë për lundrim në Papenburg të Gjermanisë për t'u testuar. "Mbretëresha" e deteve, që quhet "Aidanova LNG" dhe që mban plot 5 200 persona, do t'i nisë udhëtimet në vjeshtë. Anija ka një gjatësi prej 337 metrash dhe gjerësi 42 metra. Anija ka 2 600 dhoma, ku përfshihen 31 suita, 312



kabina të brendshme, 198 kabina me ballkon oqeanik dhe 1 655 kabina me ballkon.

BARSOLETA E DITËS



E pyetën një të moshuar se çfarë të këqijash ka pleqëria?
- Tri janë të këqijat e pleqërisë, tha i moshuari.
- E para është skleroza. Dy të tjerat i harrova.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird




Në ora 18:20

"FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

"ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

"LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.




DASHI

Keni lajme të bukura që doni t'i ndani me të gjithë. Do ta gjeni disponibilitetin e personave që ju duan dhe ju mbështesin.



DEMI

Këtë ditë doni të merrni përgjegjësi të reja mbi vetë. Planet tuaja do t'i konsultoni me partnerin.



BINJAKËT

Sot do t'ju shoqërojnë gjatë ditës suaj persona të gëzueshëm dhe mjaft të vendosur.



GAFORRJA

Instinkti juaj ju çon drejt një drejtimi që nuk ishte destinacioni juaj parësor. Gjithsesi është më i miri.



LUANI

Sot mjafton t'i ndani mirë oraret e ditës dhe çdo gjë do t'ju shkojë siç dëshironi. Parteri ka një kërkesë për ju.



VIRGJËRESHA

Objektivat e ditës suaj përqendrohen vetëm tek puna. Mos harroni që dhe familja ka të njëjtën rëndësi.



PESHORJA

Ditën e sotme duhet të gjeni aleatë të fuqishëm për të mbrojtur një projekt që ka kundërshtitë e veta.



AKREPI

Nëse doni të merrni në dorë fatin tuaj sot, mundohuni të qartësoni disa situata të dyshimta.



SHIGJETARI

Në ditët e shkuara keni bërë një gabim që do t'ju duhet pak kohë për ta rikuperuar. Gjithsesi do të dini si të veproni.



BRICJAPI

Sot një çështje financiare do t'ju shkaktojë shumë stres. Nëse ju kap paniku nuk do të arrini të zgjidhni gjë.



UJORI

Nëse keni mundësi për të mbaruar punë, mos e neglizhoni. Koha nuk ju premton për ta gjitha projektet tuaja.



PESHQIT

Sot do të bëni zgjedhje që shkojnë ndesh me ato që vendosni zakonisht. Do të rezultojnë mjaft produktive.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

KALMAR - OREBRO

1

AALBORG - ESBJERG

1

ATHLETIC BILBAO - HUESCA

1

Flamurtari e 'fik' kampionen, Prishtina fiton derbin ndaj '89-shit

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 GUSHT - Java e dytë në elitë ka qenë shumë interesante, kurse nuk kanë munguar as befasishtë. Për një gjë të tillë është përkujdesur Flamurtari i Prishtinës që, nën drejtimin e Arsim Thaqit, e regjistroi edhe fitoren e dytë, duke e mposhtur kampionen aktuale, Dritën (1-3). Në derbin në të cilin u pensionua legjenda e Trepçës '89, Shpëtim Idrizi, fituese foli Prishtina ndaj '89-shit me rezultat 0-2. Fitores të dielën i është gëzuar edhe Ferizaj që e ka mposhtur Lirinë me rezultat minimal 1-0.

Drita-Flamurtari 1-3

Skuadra e Dritës nga Gjilani pësoi humbje befasuese në ndeshjen ndaj Flamurtarit me rezultat 1-3. Kampionët aktualë e mbyllën pjesën e parë me epërsinë 1-0, pasi Ervis Kaja e mposhti portierin mysafir në minutën e 23-të. Në fillim të pjesës së dytë Veton Kabashi barazoi rezultat në 1-1. Pas këtij goli të shënuar, kuqezinjtë nga kryeqyteti arritën të kalojnë në epërsi nëpërmjet Alban Shillovës në minutën e 80. Sulmuesi Shillova në fund të ndeshjes e realizoi edhe golin e dytë dhe të tretin për Flamurtarin. Në xhiron e tretë, Flamurtari e pret KEK-un, kurse Drita i shkon në Prizren, Lirisë.

Trepça '89-Prishtina 0-2

Prishtina e ka nisur në mënyrën më të mirë edicionin e ri, pasi ka shënuar fitore me rezultat 0-2 ndaj Trepçës '89, në stadiumin "Riza Lushta" në Mitrovicë. Në minutën e 23-të Prishtina kaloi në epërsi falë autogolit të shënuar nga Elton Basriu, i cili e dërgoi topin në rrjetën e portës së vet, pas një harkimi të Gauthier Mankendas. Nga minuta e 77 vendësit luajtën me një lojtar më pak, pasi me karton të kuq u ndëshkua Ylber Maloku. Në fund të ndeshjes golin e dytë për kryeqytetasit e shënoi Lorik Boshnjaku. Në këtë ndeshje derbi u përshëndet nga futbollit Shpëtim Idrizi, i cili për një kohë të gjatë ishte kapiten dhe lider i '89-shit.

Ferizaj-Liria 1-0

Fitore shumë të rëndësishme ka shënuar Ferizaj i Afrim Tovërlanit në përbalje me Lirinë e Prizrenit (1-0). Vendësit e shënuan golin e fitores gjashtë minuta para fundit të ndeshjes, kurse shënoi Avdyll Haliti. Ferizaj



mbeti me një lojtar në minutat e fundit, por Liria nuk arriti ta barazojë rezultatit dhe në këtë mënyrë e regjistron edhe humbjen e dytë në këtë edicion.

Drenica-Feronikeli 0-0

Përforcimet e shumta të realizuara gjatë afatit kalimtar të verës nuk kanë dalë të jenë të suksesshme për skuadrën e Feronikelit, e cila barazoi edhe në xhiron e dytë. "Nikli" pati shumë raste në ndeshjen ndaj Drenicës, e cila u zhvillua të shtunën në stadiumin "Bajram Aliu", por asnjë nuk arriti ta konkretizojë në gol dhe rezultati final i ndeshjes ishte 0-0. Në xhiron e radhës ekipi kuqez, Drenica, i shkon Prishtinës, kurse Feronikeli në Drenas e pret Ballkanin.

Ballkani-Llapi 0-3

Ashtu siç kishin paralajmëruar futbollistët e Llapit se do të këndellen pas humbjes nga Drenica në ndeshjen ndaj Ballkanit - ndodhi, pasi llapjanët arritën t'i marrin pikët e plota në Suharekë falë fitores me rezultat 0-3. Vetëm pas gjashtë minutave lojë, mysafirët e hapin serinë e golave nëpërmjet Mentor Zhdrellës, i cili realizoi nga gjuajtja e lirë. Në minutën e 24-t sulmuesi i transferuar nga Prishtina, Ahmed Januzi, realizoi për 0-2. Në pjesën e dytë ishte skuadra e Llapit që e shënoi edhe një gol tjetër nëpërmjet ish-sulmuesit të Kombëtares së Shqipërisë, Ahmed Januzi. Pas kësaj fitore Llapi e rikthen qetësinë në klub, kurse Ballkani në ndeshjen e parë si vendës pas rikthimit në

Superligë i dëshpëroi shikuesit e vet.

KEK-u-Gjilani 2-3

Gjilani pas ndeshjes së anuluar me Prishtinën në xhiron e parë, në xhiron e dytë ka arritur fitore ndaj KEK-ut në Kastriot (2-3). Transferimet e bëra gjatë afatit kalimtar të verës ishin vendimtare për fitoren e skuadrës mysafire, kurse ndeshja e zhvilluar në Kastriot ishte mjaft dinamike dhe me shumë gola të shënuara. Për vendësit shënuan Muhamet Rakovica (24) dhe Vigan Veliu (67), kurse për mysafirët Brunild Pepa (2), Trevin Cesar (36) dhe Wilber Perez (86).

IPKO Superliga - Java e dytë

Drita-Flamurtari	1-3
Trepça '89-Prishtina	0-2
Ferizaj-Liria	1-0
Drenica-Feronikeli	0-0
Ballkani-Llapi	0-3
KEK-u-Gjilani	2-3

Tabela

1. Flamurtari	6 pikë
2. Drenica	4
3. Gjilani	3
4. Prishtina	3
5. Drita	3
6. Llapi	3
7. Ferizaj	3
8. Ballkani	3
9. Feronikeli	2
10. Trepça '89	1
11. Liria	0
12. KEK-u	0
Në xhiron e radhës takohen: Feronikeli-Ballkani, Flamurtari-KEK-u, Gjilani-Trepça '89, Liria-Drita, Llapi-Ferizaj, Prishtina-Drenica.	

SHKURT

Portieri i Manchester Cityt pranon ftesën e Kosovës

Portieri i Manchester Cityt, Arjanet Muriqi, e ka pranuar ftesën e Përfaqësueses së Kosovës në futboll. Portieri 20-vjeçar është i gjatë 1.98 cm dhe luan për U-23 të Manchester Cityt, kurse ka kontratë deri më 2021. Bëhet fjalë për portierin shqiptar nga Mali i Zi, i lindur në Zvicër, që një kohë ka mbrojtur ngjyrat e Cyrhut dhe me pas ka kaluar te Manchester City. "Jam shumë i lumtur që pas shumë bisedave që patëm me krerët e FFK-së dhe pas bashkëbisedimit me djalin tim, Arjanetin, ai vendosi t'i bashkohet Kosovës. Arjaneti ishte pjesë e Kombëtares malazeze për të rinjtë, por ai dhe unë si baba vendosëm t'i themi po Kosovës e t'i bashkohemi trugut tonë të cilit i takojmë. Arjaneti do ta japë kontributin e tij, kurse Kosova ka fituar një portier me perspektivë. Besoj se Kosova ka një të ardhme të ndritur e që shpresoj se edhe Arjaneti të jetë pjesë e këtij suksesi dhe uroj gjithë të mirat", ka thënë babai i portierit Samir Muriqi.

Rahoveci përforcohet me amerikanin Amir Maddred

Klubi i Basketbollit Rahoveci ka siguruar shërbimet e qendrës amerikane Amir Maddred, bën të ditur klubi përmes faqes zyrtare. "Basketbollisti nga ShBA-ja dhe klubi ynë kanë përfunduar të gjitha procedurat e transferimit të Maddred në Rahovec, ndërsa ky i fundit arrin të martën në Kosovë kur edhe pritet t'i bashkohet pjesës tjetër të skuadrës në stërvitje", thuhet në njoftimin e KB Rahoveci. Maddred është 205 centimetra i gjatë, derisa ai ishte pjesë e disa kolegjeve në New Jersey, së fundmi pjesë e skuadrës Slippery Rock University. Ai për këtë skuadër ka zhvilluar 27 ndeshje me një mesatare prej 10.5 pikësh për ndeshje.

Donjet Shkodra dërgohet te Kukësi B

Donjet Shkodra me një vendim të klubit është transferuar te Kukësi B, madje dhe është gjobitur. Siç kemi bërë me dije, shkaku është kontrata e majme që mesfushori ka, rroga mujore prej 7 000 eurosh i është propozuar nga klubi që t'i përgjysmohet, gjë që kategorikisht nuk është pranuar nga lojtari. Tashmë palët kanë mbetur në "vendnumëro", pasi asnjëra nuk mund të veprojnë ndryshe për shkak se dëmi ndaj vetes është i madh. Nëse Kukësi prish kontratën në mënyrë të njëanshme, atëherë do t'i duhet t'i paguajë lojtarit rrogat për një vit. E njëjta gjë është edhe për futbollistin. Kështu që palët, nëse nuk gjejnë konsensus dhe e prishin kontratën, gjyqi është rruga që vendos pikat mbi "i".

Xhaka asiston në rikthimin si titullar

Reprezentuesi i Shqipërisë, Taulant Xhaka, është rikthyer të luajë titullar me skuadrën e Bazelit pas plot katër muajsh mungesë si pasojë e dëmtimeve të njëpasnjëshme në gju. Në ndeshjen ndaj Zurichut, Xhaka shërbeu me një top të shkëlqyer zvicëranin Kampo, i cili më pas dërgoi topin në rrjetën e portës së vendësve. Rikthimi i Xhakës është një lajm shumë i mirë edhe për trajnerin e kombëtares kuqez, Christian Panucci. 27-vjeçari është një titullar i padiskutueshëm në sytë e teknikut italian që i duhet ta bëjë kthesën në ndeshjet e "Nations League" ndaj Izraelit dhe Skocisë.

Morina përforcon Prishtinën

PRISHTINË, 26 GUSHT - Basketbollisti prizrenas Altin Morina do të jetë lojtari më i ri i ekipit kryeqytetas, KB Prishtina. Lajmi është dhënë nga skuadra e Prishtinës përmes faqes

zyrtare në "Facebook". "Një nga basketbollistët më të talentuar shqiptarë, Altin Morina, do të jetë pjesë e Prishtinës. Altini së bashku me Mikailen ishin shtyllat e mbrojtjes së

Bashkimit në triumfin e tyre historik për klubin prizrenas. Altini ishte pjesë e përfaqësueses së Kosovës në të gjitha kategoritë e reja dhe në fund u ftua edhe nga ekipi senior. Me

Prishtinën do t'i hapen dimensione të reja në karrierën e tij, si në Champions League ashtu dhe në Europe Cup. Mirë se vjen, Altin!", thuhet në njoftimin e KB Prishtina.



Vetteli triumfoi në Belgjikë

BRUKSEL, 26 GUSHT - Sebastian Vetteli me Ferrarin fitoi garën e Çmimit të Madh të Belgjikës në Formula 1, një triumf i merituar i pilotit gjerman, që rihap betejën për titullin kampion. Një parakalim fantastik që piloti i "kokëkuqes" i bëri Lewis Hamiltonit në xhiron e parë vulosi këtë triumf, pasi Vetteli e ruajti kryesimin e garës deri në fund, duke mos e vënë për asnjë moment në diskutim fitoren. Ndërsa Hamiltoni, që të shtunën korri "pole" dhe të dielën u nis nga vija e parë, u detyrua të kënaqej me vendin e dytë. Në podium u ngjit edhe Max Verstappen me Red Bullin (i treti), që para fansave të vet nuk bëri më shumë se kaq. Gara dhuroi emocione e spektakël vetëm në xhiron e parë, ku ndodhi një aksident në metrat e para e ku Vetteli parakaloi Hamiltonin, ndërsa pjesa e mbetur e saj ishte një monotonie me pak surpriza dhe parakalime. Një garë për t'u harruar për Kimi Raikkonen, që u tërhoq, ndërkohë që një paraqitje të mirë bëri Valtteri Bottas, që u nis nga vija e fundit dhe u klasifikua i katërti. Mirë u paraqit në këtë garë edhe makina Force India, që u klasifikua në vendet 5-6 me Perezin e Ocon, ndërkohë që në "top-10" u renditën Grosejan e Magnussen me Haas, Gasly me Toro Rosso e Ericsson me Sauber, raporton "Telesport". Gara nis me surpriza që në kthesën e parë, me një aksident të frikshëm që përfshin tri makina. Njëvendëshja e Alonso goditet nga pas nga Leclerc dhe makina e spanjollit fluturon mbi



kokën e Hulkenbergut, pamje vërtet të frikshme, por që për fat nuk ka pasoja te pilotët. Ndërkohë që, pak metra më tutje Vetteli bëhet protagonist i një parakalimi model karshi Lewis Hamiltonit, që nuk e priste këtë sulm të ferraristit. Makina e sigurisë hyn në pistë, por pas largimit të saj nuk ka shumë emocione. Nga gara tërhiqet Kimi Raikkonen me Ferrarin, që ka probleme me makinën e vet pas kontaktit me Daniel Ricciardo në start. Gara shkon e qetë deri në mesin e saj, me Bottasin që e nisi këtë sfidë nga vendi i fundit pas penalizimeve dhe nis gradualisht të fitojë pozicione, duke u renditur i dhjeti. Edhe ndërrimet e gomave nuk dhurojnë surpriza të mëdha, pasi pilotët ruajnë pozicionet e tyre në pistë. Vetteli i pari dhe pas tij ndod-

hen Hamiltoni e Verstappen. Ky i fundit rikuperon ndaj makinave Force India që ndodheshin para tij në start, por holandezi me Red Bullin nuk ka forcën që të duelojë me dy pilotët e kreut. Edhe fundi i garës është i qetë, pa emocione (tërhiqet edhe Daniel Ricciardo 10 xhiro nga fundi) dhe në krye pilotët ruajnë diferencat mes njëri-tjetrit, pasi Hamiltoni nuk arrin ta rivalizojë me Vettelin, që fiton me lehtësi, suksesi i 52-të në karrierë. Një garë të mirë bëri Bottas, që parakalon një e nga një rivalët dhe ngjitet i katërti, duke i dhënë pikë të rëndësishme Mercedesit. Në renditjen e përgjithshme kryeson Hamiltoni, por Vetteli ngushton në 17 pikë diferencën. Gara e radhës, pas një jave në Itali.

Befason Mourinho: Asnjë nuk është i lumtur në skuadër

Java e tretë e Premierë Ligës do të mbyllet sonte (e hënë) me përballjen në mes të Manchester Unitedit dhe Tottenhamit, por situata nuk është aspak e qetë te "djajtë e kuq" dhe ai që e konfirmon këtë është vetë trajneri Jose Mourinho. Portugezi ka deklaruar se asnjë nuk është i lumtur te skuadra, sidomos pas humbjes një javë më parë ndaj Brightonit. "Është e qartë se asnjë nuk është më i lumtur te skuadra. Kam mjaftueshëm përvojë për ta kuptuar këtë gjë, sidomos kur një skuadër nuk arrin të fitojë. Nuk ke dëshirë të luash më", ka deklaruar Mourinho. Ai ka treguar se ka marrë mësim nga humbja e fundit. "Ndaj Leicesterit nuk bëjmë asnjë gabim dhe fituam, ndërsa e kundërta ndodhi ndaj Brightonit, gabuam dhe e paguam shtrenjtë. Njerëzit sot e shohin futbollin në një mënyrë pragmatike dhe në fund të marrë atë



që meriton. Nga humbja e fundit morëm shumë leksione, por është koha të reagojmë dhe të ringrihem", ka thënë Mourinho në prag të ndeshjes ndaj Tottenhamit. Trajneri

portugez ka kohë që është në qendër të kritikave të skuadra e Unitedit, madje përfillet se mund të shkarkohet javën e ardhshme në rast se nuk arrin të fitojë ndaj Tottenhamit.

SHKURT

Emery: Nuk kam mosmarrëveshje me Ozilin

Trajneri i Arsenalit, Unai Emery, e vlerësoi të vlefshme fitoren ndaj West Hamit, por mohoi zërat se qarkullojnë për një mosmarrëveshje mes tij dhe Mesut Ozilit. "Morëm një fitore të vlefshme, edhe pse kaluam në disavantazh. Kjo tregon se skuadra ka karakter dhe reagoi mirë. Por, sigurisht se duhet të përmirësohemi më shumë dhe të mbyllim mirë hapësirat në mbrojtje", ka thënë Emery. "Ozil ishte me vitezë dhe nuk ka asnjë të vërtetë në lajmin e publikuar se unë kam bërë sherr me të. Kam raport të shkëlqyer dhe ai është një lojtar i rëndësishëm për ne", ka deklaruar Emery.

Allegri lavdëron Ronaldon

Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, e ka lavdëruar Cristiano Ronaldon. Ky i fundit nuk ka arritur të shënojë as në ndeshjen e dytë ndaj Lazios. "Ronaldo është një futbollist shumë inteligjent dhe e ka kuptuar mirë diferencën mes Italisë dhe Spanjës. Ai po punon shumë dhe sot ka treguar një impenjim të madh edhe në fazën defensive. Është një lojtar që dialogon mjaft mirë me shokët dhe shumë shpejt do të vijë edhe golat e tij", ka deklaruar Allegri.

Rakitiqi konfirmon qëndrimin te Barça

Ivan Rakitiqi ka qenë i lidhur me thashethemet rreth një largimi të mundshëm në drejtim të Paris Saint Germainit. Ylli i Barcelonës i ka mohuar të gjitha dje pas ndeshjes ndaj Real Valladolidit dhe ka bërë me dije se do të vazhdojë me katalunasit. Në një intervistë me "Barça TV", mesfushori është shprehur: "Pas të gjitha fjalëve që janë thënë, tashmë ka mbaruar gjithçka, do të qëndroj. Është një nga ndjenjat më të mira ta bartësh këtë fanellë. Me shumë dëshirë jam duke vazhduar rrugëtimin me skuadrën". Ivan Rakitiqi është një nga lojtarët më të pëlqyer të Ernesto Valverde dhe është pjesë kryesore e planeve të trajnerit.

Chelsea nuk është në shitje

Chelsea ka mohuar pretendimet se klubi është në shitje pasi u shfaqën thashethemet se pronari Roman Abramovich po kërkon në mënyrë aktive një blerës serioz. "Sunday Times" ka shkruar se Abramovichi është i gatshëm ta shesë klubin, por kjo është mohuar nga "London Evening Standard" që ka deklaruar se rusi nuk e ka në plan shitjen dhe vetëm po punon t'i shtojë fondet.

Griezmanni: Nuk luajtëm mirë ndaj Vallecanos

Sulmuesi i Atletico Madridit, Antoine Griezmann, është shprehur i pakënaqur me ndeshjen e skuadrës së tij kundër Rayo Vallecanos (1-0). "Shpresoj se do ta dërgojë këtë klub aq më lart sa të mundem. Ne nuk luajtëm mirë. Nuk e di nëse ishte për shkak të lodhjes, por ne do të përmirësohemi dhe duhet të vazhdojmë të punojmë. Ne do të tentojmë të fitojmë të gjitha ndeshjet që i kemi. Në fund do ta shohim se sa larg mund të shkojmë. Jam shumë i lumtur dhe krenar që jam këtu", ka thënë Griezmanni.



Me datën 27 gusht 2018 bëhen 13 vjet nga ndarja e atdhetarit të shquar

Prof. Azem (A) Beqiri 1939-2005

Vëlla, axhë me gjithë virtytet e një burri të palëkundur për të drejtën njerëzore, malli nuk shuhet kurrë për ty.

Atdhe dashuria, vetëflim dhe vepra jote na bëjnë të ndjejmë mungesën tënde çdo ditë e më shumë. Krenaria jonë rritet edhe më shumë për ty, si prijës i fisit, mësues i të drejtës, ndershmërisë dhe dashurisë për atdheun që aq shumë ju përkushtove.

E përkujtojnë: vëllai Ejupi, kunata Kashirja, nipi Taulanti dhe mbesat Vlora, Valbona dhe Visarja me Jetonin, Orgesin, Orhidean dhe Oriku nga Prishtina dhe Holanda.

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës "Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO

Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët "Razim Cokli" në Brod



OPSTINA STRPCE
KOMUNA SHTERPCË
MUNICIPALITY OF STRPCE

Njoftimi për rishprehje të interesit

Emri i shkollës: "Razim Cokli"
Komuna: Shtërpçë
Data: 27.08.2018
Emri i kontratës: Zbatim i TI në mësimdhënje
Numri i kontratës: ESIP/C1.3/104- ESIP/SDG/104-CS/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe ShFMU "Razim Cokli". Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

**Trajnime të mësimdhësve në programin:
Zbatimin e teknologjisë informative në mësimdhënje**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
 - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën : **ShFMU "Razim Cokli" në Brod , Shtërpçë – shkolla amë më së largu deri më 4 shtator 2018**
4. Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentët luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.
5. Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues:
Bektesh Bajrami
Telefoni: **049929107 dhe 045593226**
E-maili: **b_24viga@hotmail.com**

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Ruzhdi Xhyliqi" Marali
Komuna: Malishevë
Data: 27.08.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/055-ESIP/SDG/055-CS/1.3	Trajnimi i Këshillit Drejtues të Shkollës

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Ruzhdi Xhyliqi"- Marali-Malishevë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimit të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:
 - Trajnimi i Këshillit Drejtues të Shkollës
2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
 - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën e shkollës "Ruzhdi Xhyliqi"- Marali-Malishevë. më së largu deri më **04.09.2018**.
4. Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentët luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Labrije Hoxha
Telefoni: 044817639 & 049999935
E-maili: shkolla_ruzhdixhyliqi@hotmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Shf.mu "Osman Mani" Firajë Komuna Shtërpçë
Data: 27.08.2018
Emri i kontratës: Zbatim i TI në mësimdhënje
Numri i kontratës: ESIP/C1.3/103-ESIP/SDG/103-CS/1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles "Osman Mani", Firajë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:
Trajnim i mësimdhënësve: Zbatim i TI në mësimdhënje
2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
 - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën: **Shkolla fillore e mesme e ulët "Osman Mani" , Firajëmë së largu deri më 04.09.2018**.
4. Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentët luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.
5. Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Ganimete Xhemajli
Telefoni: 044380029
E-maili: gnaimetexhemajli@hotmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Emin Duraku"-Dragobil
Komuna: Malishevë
Data: 27.08.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/051-ESIP/SDG/051-CS/1.2	Trajnimi i mësimdhënësve për TIK

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Emin Duraku"- Dragobil-Malishevë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:
 - Trajnimi i mësimdhënësve për TIK
2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
 - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën Shkolles "Emin Duraku"-Dragobil-Malishevë., më së largu deri më **4.09.2018**.
4. Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentët luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Arianit Paçarizi, Isuf Ulluri, Kapllan Paçarizi
Telefoni: 049262493, 049579871, 044473841
E-maili: pacarizarianit@gmail.com



ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)

- ★ N&C Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Emisintelladonna Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Nacionales Salvadoreñas S.A. **El Salvador**, Quality
- ★ Fibiak S.p.ka. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Fuzada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.J.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kočila ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zetal CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Parlex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola

Calidad, Innovación, Pura
— Since 1905 —